

82  
1975

GJURMË  
QË NUK  
MBULOHEN  
KURRË...

TREGIME

854-32-822

GJ 95

854-32-822

5.

GJURMË QË NUK MBULOHEN KURRË...

TREGIME

1024

**SHËNIMI E SHËNIT  
GJURMËT**

~~45410~~

SHËNIMI BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

8 214-22-853

2

GLORIE DE NUK MBULOHEN KURRE...

10501

TREGIME

THE MOTHER AND THE CHILD

14274

Ttirazhi 7000 kopje      Format 78x109/32      Stash: 2204-65

Shtyp NISH Shtypshkronjave «Mihal Duri»

Stabilimenti «8 Nëndori» — Tiranë, 1968

## GJURMË QË NUK MBULOHEN KURRE...

Gjysmë ore bisedë të mirë me një mësuese. Edhe ajo kishte zbritur në Librazhd për të blerë ushqime. Trastat i kishte vënë nga e djathta. Kurse nga e mëngjëra, kishte një pako me gazeta...

— Mësuese je?

— Po.

— Ku?

— Në Lunik.

— Ka bërë shumë dëme atje.

— Shumë... Po tani po u japim fund ndërtimeve dhe meremetimeve. Shtatë ditë para afatit.

Shoferi shikonte rrugën e ngrirë dhe me shumë kujdes zbriste pjesët e kthesave të pjerrta.

Folëm shumë për vullnetarët, për specialistët, për Tosun Shahinasin. Se mësuesja kish qenë aty kur ra Tosuni në punë e sipër, kish qenë aty kur shokët e tij dhe gjithë fshati e kish përcjellë, kish qenë aty kur erdhën nga Maliqi gjithë ata vullnetarë nga familja e Tosunit, midis të cilëve edhe e shoqja.

— Luftë!... Jemi si në luftë, — fliste shoferi. — Armiku që na goditi që i papritur. Nuk sulmoi as nga kufiri e as nga qielli, po nga fundi i dheut — dhe për një çast ktheu kokën nga ajo. I pa fytyrën dhe sytë e kaltërt. — Si e ke emrin?

— Gëzime.

— E gëzofsh, — dhe qeshi. — E di, Gëzime? Unë kam tetëmbëdhjetë ditë që mbar materiale. Pardje bëja rrugën e Peshkopisë. Për kureshtje pyeta një shok aty në Shtabin e Shupenzës. «Mor, sa material kemi prurë

gjer tani?» Dhe ai më tha: «Dy javët e para kini prurë këtu njëzetmijë tonelatë material ndërtimi».

Gëzimja e dëgjonte. Po sytë i mbante nga rruga e ngrirë. Ajo dëgjonte shoferin t'i fliste për gjithë ato që ai kish parë në zonat e Shupenzës, të Maqellarës dhe të Ostrenit.

Gëzimja iu lut që ta ndalte maqinën se do të zbriste në lokalitetin e Lunikut. I dha dhe dorën. Dhe shoferi ja shtrëngoi. Dhe për fajin e syve të Gëzimes, harroi të blente pakëz bukë dhe pakëz djathë, se ashtu kishte vendosur; «Bukë e djathë do të blej te dyqani i Lunikut, se ai djathë më pëlqen.»

Tani kishte nisur t'i ngjitej shkallës. Dhe nuk mund të kthehej që të blente pak bukë e pak djathë. «Ha në Klenjë. — tha me vete. — E mirkë ishte Gëzimja. E re dhe e bukur. Dhe zërin e kish të ëmbël».

Maqina ngjitej me zor. Të dy anët e rrugës ishin ngritur shumë nga dëbora që kish mënjanuar traktori. Pas zhdukjes së syve të Gëzimes, shoferit iu kujtua dialogu i shkurtër që u zhvillua midis tij dhe shokut që edhe fliste, edhe mbante pranë veshit kufien e telefonit, edhe shënonte në një listë të gjatë, aty në shtabin e Librazhdit, nga ish nisur një orë më parë.

«Për në Klenjë! — i tha duke e parë në sy ai që edhe fliste, edhe mbante pranë veshit kufien e telefonit, edhe shënonte me laps në një listë të gjatë.

«Si urdhëron!

«Nuk flas me ty, po me Bujarin! Prit, mos u largo nga telefoni. Prit të them. Ti, Bujar, nis! Në Klenjë!... Në Klenjë!...»

«Si urdhëron!...»

Dhe para se të hidhte këmbën përjashta orakut të shtabit, në trotuarin e ngrirë që dukej si një kristal gjigand i goditur shumë herë me varë, dëgjoi dhe këto: «Kontrolloji mirë zinxhirët e rrotave të pasme». Po ky zë nuk ishte i atij shoku që edhe fliste, edhe mbante pranë veshit kufien e telefonit, edhe shënonte me laps në një listë të gjatë. «Si urdhëron! I kam fare mirë!». Këto Bujari i tha përjashta, në trotuarin e ngrirë. Bujari

dëgjoi edhe «Udhë e mbarë!» po këtë «udhë e mbarë» nuk e mori vesh se kush ja tha nga gjithë ata shokë që hynin e dilnin me nxitim në atë zyrë të gjerë të shtabit. Këtë atmosferë luftarake Bujari e pëlqente shumë. Dhe çuditej se si edhe vetë ai, që kish qenë pak i mefshtë, i truar dhe i mbyllur, tani ish gjallëruar dhe, i rrëmbyer nga kjo valë revolucionare, kërkonte që të mos mbetej në bisht të shokëve.

Maqina ngjitej me shumë zor. Dhe, sipas ritmit të maqinës, i punonte mendja. Kur rrotat e pasme nisën të rrotulloheshin në vend, i bëhej zëri i atij shoku që i kish thënë «Kontrolloji mirë zinxhirët e rrotave të pasme», kur ky kish qenë në trotuarin përjashta shtabit. Kur të gjitha rrotat shkonin për bukuri, ky sillte ndër mend sytë e Gëzimes dhe fjalët e saj.

Rrotat shkisinin. Bujari, pa tjetër, duhej të kalonte shkallën e Lunikut, atë të Llangës, para dreke, të hidhej në Streblevë e pastaj të ngjitej në Klenjë, të hante pakëz sa ta shkarkonin maqinën e pastaj të kthehej, të shkonte në park, të flinte disa orë në shtëpi, se kishte njëzet orë që udhëtonte e të nesërmen që pagdhirë të nisej.

«Rrugë e keqe kjo». Shikonte nga e mëngjëra: humnerë e bardhë. Shikonte nga e djathta: mal i pjerrët si thikë, me shkëmbinj që dukeshin gati për t'u lëshuar. Dhe maqina thua jse numëronte në vend. Bujari nxirrte kokën, shikonte rrotat e pasme. Mirë ishin. Zinxhirët nuk ishin këputur. Po pse nuk ngjitej? Ç'kishte? Edhe pak sa të kalonte këto dhjetë metra, e pastaj dilte aty, në atë lis. Shikonte telat e telefonave që ishin mbështjellë me një akull të trashë sa bishti i kazmës; shikonte akujt e trashë stalaktitë që vareshin nga shkëmbinj të në forma të çuditshme. Dhe bora nisi të binte. Xhami ngrinte. Bujari e kruante me thikë. Po nuk pastrohej. Bora që binte, nisi të dendësohej. «O Burra, sa të kaloj këtë qafë! Se mos më zë këtu furtuna.» Bujari kishte dëgjuar shumë për furtunën, për stuhitë, po vetë nuk i kish parë.

Maqina uturinte si e tërbuar. Sikur deshi t'i zinte gojën stuhisë. «Edhe një metër! Edhe pak! Ja, dola në

atë lis! Po lis më nuk dukej. Dëbora dëndësohej. Xhami ngrinte nga brenda. Nga jashtë mbulohej me dëborë. Bujari nxirrte dorën. E hiqte. «Ja edhe pak. Ja edhe pak. Sa të kaloj këtë shkallë të keqe. E të dal në Llangë».

Kur përmendi pa zë emrin Llangë, u mendua ca çaste, «Llangë, Letëm, Qarishte, Po! Udhë e babait. Atëhere, atëhere, Brigada e Parë. Brigada e Parë.»

Fryma e stuhisë ishte ndezur. Vendi nuk dukej. Maqina çante dalëngadalë përpara. Gjurmët e Brigadës së Parë nisën të ndrisnin. Ato nuk ishin gjurmë që kyçeshin në arkivat apo në zemrat e atyre që i kishin lënë. Ato ishin gjurmë që nuk mund t'i mbulonte kjo stuhi zemërake, e cila dëborën e hidhte pa kursim, e hidhte me tërbim, e hidhte me lopatën e furtunës në shtigje dhe kthesa të xhadesë. Gjurmët e babait nisën të bëheshin fenere, në atë stuhi, e cila gati sa s'po ngrinte në erë si pendë edhe ZISI-in e ngarkuar me tulla.

«Edhe pak, o ZISI im! Edhe pak! Qëndro i fortë... se këtej ka kaluar dhe im, atë. Atëhere. Atëhere, me Brigadën e Parë. Ecë! Përpara! Në Klenjë! Sa ta kalojmë edhe këtë shkallë. Ne jemi të mbathur. Ti i ke rrotat me zinxhirë. Im atë ka qenë i zbathur. I uritur...»

Maqina ngeci. Bujari hapi derën. Aq e dendur ishte derdhja e dëborës nga lopata zemërake e furtunës, sa ai nuk shihte as një pëllëmbë më tej. Me duar kontrolloi rrotat e mbuluara me dëborë. Mbahej se mos e rrëmbente furtuna. U fut brenda. Mbylli derën. U shkund nga dëbora. Fërkoj fytyrën. Ndënji disa çaste ashtu si i mpirë. Pastaj e mblodhi veten. Motorin e la të ndezur. Edhe dritat i la të ndezura. Kot i ra për shumë çaste borisë. Po ajo as që u dëgjua.

U mbështet te timoni, duke parë xhamin si mur të bardhë. «Babai.» Dhe nisi të kujtonte gjithë ato që sa e sa herë ja kish thënë babai «Llangë, Qarrishte, Letëm, Zgozhd, Brigadë e Parë... Dhe unë këtu jam. Sa do të mbajë kjo stuhi? Një orë? Dy, tri, pjesë, dhjetë? Një natë? Nesër unë jam në Klenjë. Pastaj do të kthehem...»

... Përtej përroit të thellë, në fshatin Llangë, stuhia përplaste dëborën në shtëpitë e porsa ndërtuara dhe në

ato që akoma nuk ishin ndërtuar. Në njerën nga ato shtëpi që ishin prishur nga tërmeti dhe që atë ditë u meremetuan dhe ku zjarri u ndez, familja merrej me pastrimin dhe vendosjen e teshave në vendin e tyre. I zoti ishte një i ri pak a shumë sa Bujari. Kishte një shishe raki dhe u nis për t'ua dhënë specialistëve që kishin ardhur nga Saranda dhe nga Elbasani dhe që banonin në një barakë, pranë shkollës. Ishte i fuqishëm, ky fshatar. Dhe këtë stuhi e kish njohur dhe herë të tjera. Kokulur, duke matur mirë çapet dhe vendin që njihte mirë me pëllëmbë, arriti te baraka. Specialistët u çuditën dhe u gëzuan shumë, sidomos kur panë se shisja ishte njëkilëshe. Pinë dhe kënduan. Për Partinë ngritën dolli dhe fshatari ngriti dolli për specialistët.

Vonë, shumë vonë, kur i riu fshatar mori rrugën e kthimit për në shtëpinë e tij, vuri re se kudo vendi ishte bërë mal me dëborë. Herë zhytej gjer në gjoks në dëborë, herë gati sa s'zhytej i tëri. Po ai ishte mësuar në kohëra të tilla. Xhanxhin përjashta! Kur furtuna pukonte ndonjë çast, ai shikonte bardhësirën e natës. Nuk dallonte asgjë. Pas pak hodhi sytë përtej në xhade dhe iu duk sikur pa një dritë. U ndal, se furtuna e dendësoi hedhjen e dëborës me valë të ngjeshura. Dhe kur u ndodh përpara shtëpisë së tij, e ktheu përsëri kokën andej nga iu bë sikur pa dritë. Ndënji disa minuta me sytë drejt vendit ku iu bë sikur pa dritë.

«Dritë, — tha me vete. — Ndonjë njeri, apo ndonjë maqinë...» Nuk u fut në shtëpi. Mori drejtimin për te vendi ku pa dritë në mes të tufanit. Po që të shkonte atje, ku pa dritë, ditën me kohë të mirë, duhej të paktën një orë. Tani, sa kohë do të bënte — dhe a do të mundte të ecte — që të arrinte gjer atje?

... Bujari këndonte një këngë. Motori ishte ndezur. Orë nuk kishte. Kur do të mbaronte nata? Natë e gjatë e vitit: 22 dhjetor. «Po Gëzimja a do të jetë tani në Lunik? Pse nuk bleva pak bukë e pak djathë te dyqani i Lunikut? Ka djathë të mirë dyqani i Lunikut. Ka dhe biskota. Ka dhe llokumë. Ka dhe shishe me konjak, dhe me fërnë. Pse nuk bleva një shishe? Ta kisha këtu,



rezervë, se s'dihet. Me këtë kohë?» Motori lëshoi disa shfryrje si ngashërime dhe heshti. Bujari u mundua që ta ndizte, po më kot. «Ç'pati? Benzinë ka akoma» Dha e dha se mos e ndizte, po më kot. Me shumë zor çeli derën. «Të zbras ujin. Të zbras ujin se mos ngrin e çahet kazan!».

Kur u fut përsëri brenda, duart i kishin ngrirë. U mbështoll me një batanie.

Në ato çaste, fshatari i ri që ish drejtuar për atje ku kish parë dritë, ishte futur në një përrua, prej nga dukej se nuk do të dilte kurrë. Me këmbë e me duar kërkonte vende më me pak dëborë. «Bëra gabim, mendonte, që nuk lajmërova shokët e shtabit, shokët e partisë...».

Patjatër që mesi i natës kishte kaluar. Dhe frymëmarrja e stuhisë dukej e lodhur. Dëborë nuk binte më aq shumë, po era frynte si me thika të ngrira. Bujari zuri të dridhej. «Si tha Gëzimja? Erdhi e shoqja e Tosunit në Lunik për ta zëvendësuar. Sa erdhën? Tridhjetë veta? Sa? Dëshën të vinin me mijëra?»

I dilnin përpara gjithë njerëzit që kish parë në shtabin e Shupenzës e në shtabin e Librazhdit; vargu i pambaruar i maqinave me targa nga të katër anët e Shqipërisë, vullnetarët që këndonin këngë devollitshe, këngë himarjote, këngë myzeqare, këngë skrapari, këngë nga Korça, nga Përmeti, nga Shkodra, nga Elbasani, nga Tepelena, nga Vlora... Këto këngë tani sikur bëheshin një dhe bashkë me suferinën i oshëtinin në vesh... «Të fuqishëm jemi. E mundëm dhe këtë armik të papritur që na sulmoi nga fundi i dheut».

I dukej sikur flinte. I dukej sikur motori ndizej. I dukej sikur shkarkonte tullat në Klenjë. I dukej sikur e ëma i thërriste që të mos ikënte pa ngrënë e pa çorapet e leshta. Pastaj zëri i babait: «Në Llangë, na doli një fshatar i cfilitur, po na pruri bukë, bukë, bukë... dhe na dha informata të sakta mbi lëvizjen e armikut, që kish dalë si ujk për të na prerë rrugën... Po ne ecnim përpara, përpara...»

Fshatari i ri dhe i fuqishëm kishte arritur vendin e xhadesë. Mendohej të gjente vendin ku kish parë

dritë. Agimi i ftohtë po binte. Kudo kallkan. Fshatari nuk la skutë pa parë. Aty poshtë, në një kthesë të xhadesë, pa një gjë të ngritur. «Mos ka rënë ndonjë shkëmb», mendoi. Andej u drejtua. Ecënte mbi vendin e ngrirë. Dëborë më nuk binte. Po kudo kallkani ishte bërë si mermer kristali. Aq i fortë, sa t'i bije dhe me pushkë nuk coptohej as edhe një centimetër. Fshatari e kuptoi. Aty ishte një maqinë. Nxitoi, duke shkarë sa të arrinte atje. Me ankth. Trembej se mos e gjente shoferin të ngrirë. Tamam, drita që kish parë mbrëmë, andej vinte. Kur u afrua pranë, pa maqinën të bërë si një blok akulli. Nuk dukej se nga e kishte drejtimin. Fshatari dalloi me vështirësi se ku mund të ishte dera. Nga ana e djathtë. Thirri fort. Me duar shqiste copat e akullit. Dhe me fuqi e çeli derën e ngrirë. Bujari aty ishte. Akoma shikonte ëndërra të çuditshme që shoqëroheshin me tregimet legjendare të babait.

— Shok! Shok!

U fut brenda. E tundi. Bujari çeli sytë dhe qeshi.

— Erdhëm? Në Klenjë?

— Këtu je në shkallën e Llangës!...

— Në Llangë?

Fshatari nisi ta fërkonte, t'i fliste, ta ngrohte me frymën e tij, me fjalët e tij.

Ra agimi. Ra drita e ditës mbi atë vend të ngrirë. Bujari nuk e dinte se pak më poshtë tij kishin mbetur gjashtë maqina të tjera. Të bëra të gjitha si blok akulli. Po të gjashtë shoferët tregonin qyfyre. Bujari nuk e dinte se, dy kilometra më poshtë, ishin shokët që vinin nga Luniku. Me traktorin «Stalinec», me konjak e me ushqime. Bujari nuk e dinte se ushtarët e repartit, aty më lart, nga Strebleva, ishin afruar e vinin njësh-kolonë për t'i ardhur në ndihmë. Ai qeshi kur pa fshatarin që e puthi.

Ku ta dinte Bujari se ai fshatar që i sillte shpirtin në vend, ishte biri i atij të varfëri nga Llanga, që atëhere, në marshimin legjendar të Brigadës së Parë, i kish dhënë bukë babait të tij dhe Brigadës informata të sakta mbi lëvizjen e armikut...

Nuk fliste dot. Se dridhej i tëri. Mezi e pyeti:

— Nga je?

— Këtej, nga Llanga, shok. A je mirë?

Bujari tundi kokën i gëzuar. Nuk mund t'i thoshte:

«Jam fare mirë...».

*Nxjerrë nga gazeta DRITA Nr. 53, 1967.*

HAPAT E FUNDIT TË «STËRGUT»

«S'paska xhanxhin në udhë! E po, ca më mirë, ca më mirë. Ç'më zë s'këlldia mua se s'ka njëri?» — mendoi njeriu i gjatë, i kërrusur, i veshur me xhybe. Prapa shpinës, drejt perëndimit, rrukullisej dielli i ftohtë i majit. Ai e ndjente rrukullisjen e tij duke vështuar hijen e vet. Hija e shtrembër, e murme, zgjatej e lëvrinte deri në gruroret. Torba e rëndë e tërhiqte më të djathtë. Ai doli në rrugën e qerreve. Hija u stërgjat edhe më e u cungua nëpër kanale. Vetëm hija e zezë e torbës lëkrehej me ngulm nëpër pluhurin e udhës, si një gungë.

«Ty... ty... ty...! Leqendi e madhe me këtë torbë! Që s'gjeta dot një gomar e t'ja hipja! Edhe Aliu, tek i cili kisha shpresë, më gënjeu se gjoja e paskej gomarin në mal!»

Kështu, njeriut të gjatë i vinin në krye ca mendime të turbullta si uji në gjurmë hajvanësh.

Po ngrysej. Duhej të bënte katër orë udhë, natën. I mjeruar nga mendimet e veta, që i quante «të s'këll-disura». Për një çast nuk e kuptoi se ishte mbi urën e varur mbi lumë. Nuk e dëgjoi llapashitjen e vrazhdë të ujërave. Pastaj, iu muarën këmbët, sepse ura prej thuprash lëkundej, dhe u mbështet pas telave të trashë. Teli ishte i ftohtë dhe uji atje, nën këmbët, iu duk i frikshëm. Vorbujt sikur e ndillnin. Hoqi vështrimin nga ujërat dhe e nguli në arat, rrëzë lumit, ku dikush mbush-te patatet me dhe. Në ledh, i penguar, përtypte gjembaçë dhe radhiqe një gomar bojalli, Murro.

Fshatari, sikur ta kish ndjerë mbi shpinë vështrimin

e ngulët të njeriut me xhybe, e la shatin dhe ktheu fytyrën drejt urës.

— A...a...Po ikën, o Musa efendi? — tha.

— Po iki, Braho...po iki! — u përgjegj me pikëllim njeriu me xhybe. — Dhe ndofta s'jemi për t'u parë më. Eja të takohemi!

— Mos e thua atë fjalë, efendi! — tha Brahua dhe u ngjit nëpër shteg, drejt urës. — Vetëm mali me mal... —

— Ashtu, ashtu! Allahu e ka në dorë! Siç na krijon dhe na bashkon, ashtu edhe na ndan. Sikush ka udhën e tij, Braho!

Brahimi u ngjit mbi urë. I shtrëngoi dorën. Pëllëmbët i kish me baltë të përtharë. Sikur i ardhi një e ndrojtur pa kuptim, se mos kjo baltë ndynte pëllëmbët e bardha të efendiut.

— Të dhëntë zoti ymër të gjatë ty dhe evlatëve — tha Musai. — Ti, Braho, ke qenë tërë jetën njeri i urtë dhe me mend në kokë!

«Ky Brahua është njeri i butë dhe i leshtë» — mendoi me vete njeriu me xhybe dhe vështroi tinëz Murrin që përtypej përsëri, te ledhi.

Brahimi e kish parë njeriun me xhybe që larg dhe, për çudi, i ish dukur sikur lëkundej shumë në të dy këmbët, si një çalaman, sikur e frynte era dhe, për herë të parë, iu duk se me të vërtetë efendiu i ngjante një stërgu. Ej! ç'dreq njeriu ai Malka i Sheros që ja kish ngjitur efendiut nofkën «stërg». Kjo kish ndodhur ndofta gjashtë vjet më parë. Atëhere Malka posa ishte kthyer nga ushtria, kurse Musa efendiu kish çatisur papritur nga një fshat i Gorës, ku nuk i ecte havaja, dhe ish ngulur këtu, në rrëzë, ku kishte dhera më të majme!...

«Që atëhere kanë shkuar shumë vjet! — mendoi Brahimi. — Malka është tani sekretar rinie dhe anëtar i kryesisë! Musa efendiu erdhi e u tha edhe më, sikur të hante farmak e jo byrek! U kërrus dhe kurrizi i mbiu si xhumbë!»

Brahimi po troshitej me këto mendime, deri sa së largmi shquante vetëm shtatin e gjatë të efendiut. Por, kur i shqoi fytyrën e drobitur, të plakur, që dukej e

përvuajtur nga mendimet e gjata e të trishtuara, tha me vete me frikë, se e kish fyer më kot njeriun e zotit!

— Pse ike, o Musa efendi? — theu heshtjen Brahim. — Ti mund të rrije edhe këtu e të punoje! Këtu tokat janë të mira, të pjellshme... — Brahim s'e mbaroi dot mendimin, kafshoi gjuhën e shau veten:

«Jazëk! Më hëngri gjuha! Si më rrodhën kështu dhe harrova që Musa efendinë e përzunë nga fshati ynë?»

— Guri është i rëndë në vendin e tij! Dua të prehem në fshatin tim! — tha Musa efendiu.

«I ardhka rëndë ta kujtojë! — mendoi Brahim. Dhe i ardh i keq.

— Të kishë ndenjtur të paktën sonte!

— M'u zvordh, m'u zvordh fshati, Brahim! M'u lutën katër a pesë miq; po nuk desha. Bile, kam rënë edhe në një sèkëlldi të madhe! — Ai pa rreth e rrotull.

— Sot më ardhën për vizitë, atje në odën time, goxha millet. Po ashtu fshehur, fshehur. Do ti, që kur ikën të gjithë, gjeta në një qoshe këto para demek si hakë e këtij muaji që jemi! Ty... ty... ty... në ç'sèkëlldi rashë, o Brahim! Kush t'i ketë lënë thua ti? E dinin që unë s'ua zija me dorë! Se nuk e ka dhënë allahu që të mos u shërbesh njerëzve dhe të marrësh hakën! Kush t'i ketë lënë thua, o Brahim!

— Ku e di unë, efendi?

— Ashtu, ashtu... — tha mendueshëm. — Ku ta dish ti?

Tinëzisht, ai vuri dorën e bardhë mbi supin e Brahimit dhe pëshpëriti me një zë tjetër, të thellë e të butë:

— Mbi dhe ka ardhur mavija dhe ka turbulluar mendjet e njerëzve! Tani, atje lart, janë të zënë në një luftë! Po, do të zgjidhen nga lufta e do të lëshohen si rrufe përvëluese kundër mavijës dhe kundër atyre që marrin mendjen e mavijës... Se ja, dëgjo, Braho vëllai, ç'i pat ndodhur njëherë, një farë Demke Poçari, në Kaçjar... Po, prej mote të shkuara, ama! Këtij Demkës ja turbulloi mendjen mavija dhe zuri të thotë: «Ç'thotë efendiu, janë përralla. Unë nuk ja jap hakën! Unë do t'u vë evlatëve emra kaurë dhe s'i bëj synet! Dhe e zgja-

ti fort fortomën ky Demka! Mirëpo, do ti që pa u mbushur java, na i ngordhi kali?! Dhe si, pa? U qorrolis mu në mes të sheshit, sikur u pengua më erë! Dhe, një të penguar, kapër-kupër, u degdis në greminë! Do ti që pas një jave na e goditi një damblla, mos u kujtoftë, të ëmën? Po çfarë nëne thua ti? Banicë, ore, banicë, për qimet e pejkamberit! E shëndoshë që ta çaje e ta bëje katër! Dhe mbeti si bythak i padjegur që as të ngroh as të ftoh, pa vetëm tym lëshon për të qorruar sytë! Do ti që i sëmuret edhe djali prej një barku, dhe po tretej dita-ditës? E ahëre i ziu, duke u lebetitur, ardhi tek unë! «Derman, Musa efendi! Më hëngri gjarpëri nën gur! Ajo që bëra unë, mos u kujtoftë!» Më ardhi keq... i ziu insan! E, ç'ta zgjat më? Mezi i zbutëm xhindet me nуска e me të kënduara pa hesap! Thuaj shyqyr... shpëtuam djalin! Mbeti mashkulli, mbeti oxhaku!

— Pa... pa... pa... — tha Brahimi,

— Po ti, Braho vëlla, po të biesh në hall, prapë hajde tek unë! Të kam në teftër të veçantë ty unë!

— Falem nderit... — pëshpëriti Brahua.

— E rëndë kjo e flamosur torbë! — psherëtiu. Edhe udha është e gjatë!

— Të ta jepja edhe unë hakun... — pëshpëriti Brahimi, po s'kam të holla me vete!

— Ç'është ajo! Unë ty nuk t'i merrja kurrë! Ja, ti Brahim vëlla, po të duash, nëma gomarin me qira deri në fshatin tim dhe nesër ta kthej.

Brahimi u kujtua se desh të shpinte në shtëpi një barrë shkarpa që i kish bërë menatë, Pastaj iu kujtua edhe Demka i Kaçjarit. Dhe tha:

— Paratë mos i zërë në gojë, efendi! Gomarin po ta sjell tani.

## II

Po atë mbrëmje, Malka kthehej nga qyteti. Troku i nxituar i mushkës Giosë i shurdhonte zërat e tjerë të mbrëmjes. Ai vërshtëllente dhe, si njeri i kënaqur, kuvëndonte me vete. Në aktivin e rinisë, oganizatën

e fshatit të tyre e kishin quajtur pararojë të luftës kundër besimeve fetare e zakoneve prapanike. Nga tribuna, ai kish folur ashtu, shtruar, sikur kuvendonte me shokët e tij, se si e kishin zbuar hoxhën. Ai e kish quajtur atë, «shkopin më të fortë që i vihej rrotës sonë që çante përpara». Tregoi se si e sheshuan minarenë dhe se si xhaminë e madhe e bënë vatër kulture, se si vazhat hoqën shamitë që u mbulonin fytyrat... I kujtohet, se kishte përfunduar pak a shumë kështu: «Tani mund të themi se s'ka më njeri që të besojë dokrrat e fesë, që të gënjëhet nga hoxhallarët. Mund të themi se feja mbaroi».

E kishin duartrokatur fort. Pastaj, sekretari i partisë së rrethit e kishte quajtur përfundimin e tij të nxituar. «Lufta kundër fesë nuk mbaron me rrëzimin e minaresë... — kish thënë ai. Kjo luftë është e gjatë... «Thellë, në atë valë gëzimi e kënaqësie që e kish pushtuar, Malka ndjente se nuk qe i bindur në ishte me të vërtetë ashtu siç thosh sekretari.

«Si është e mundur që pas asaj damkosjeje të turpshme që i vumë ne Musa efendiut të ketë më njeri ta besojë?»

Më të errur, iu afrua fshatit. Gjer përtej, shtriheshin gruroret. Togjet e jonxhës së thatë prisnin qerret. Në mugëtirë, ato dukeshin tepër të murrme, si të palthara. Në një ngastër gruri dukej i shkurtër, si i mpi-rë... Mendjen e tij e pushtuan mendimet për grurin dhe jonxhat!

«Duhet ta kishin ngritur jonxhën! Koha duket si për shi! Edhe ajo ngastër gruri ka nevojë për një dorë nitrati! Duhet biseduar në kryesi!...»

U dëgjua zhurmë potkonjsh, prapa kthesës. Dhe, befas, u duk një njeri hipur mbi gomar. Këmbët e gjata e të holla i zvarriseshin përdhe. Dukej sikur koka e hiqte përpara dhe ndaj rrinte, ashtu i kërrusur, sikur nuhaste erën e qimeve të kafshës. Në errësirë, xhybja e gjatë i jepte figurës së tij pamjen e atij druri të zi që fshijnë furrat dhe që prandaj i thonë pepellashkë.

«Qënka «stërgu» — tha Malka. — Kush e di ç'qe-



sëndi ka ndjerë Musa efendiu kur e mësoi se i thërrisnin «stërg»!

Mushka e Gjosë dhe gomari i Brahos iu avitën njëri-tjetrit. Musa efendiu e vari kokën edhe më kur njohu Malkën. E shpoi gomarin në vithe dhe i tha nja katër herë «ush...i shkretë...»

— E, mor ish-efendi!... — s'iu durua Malkës. — Prapë e ke sjellë kokën këtej?

— Sot në mëngjes, shyqyr zotit, sosa në fshat për ca punë të mijat...

— Mos ke mbështjellë në torbë lesh? apo ndonjë peshtemall si myftiu? Ti, si dhelpër e vjetër që je, nuk duhet të biesh në gabime të tilla.

— Ty...ty...ty...larg qoftë! Zoti i sheh të gjitha. Vetëm ai e di zemrën time të paqme! Unë, o shoku Ismail, mora ca teshat e mia që pata lënë...

— Tani, po të më dëgjosh mua, ktheu në qytet, ble një kazmë të madhe dhe shtroju punës atje në fshatin tënd! Do të të vijë një çikë si e përpjetë në krye, se ishe mësuar të fërkosh vetëm tespihet me dorë! Dëgjova se paske thënë që të luten të vesh hoxhë në një fshat në Skrapar, po t'i s'dashke vetë! Mos u bëj budalla se s'gënjehet njeri tani nga këto fjalë!

— Ashtu... ashtu, të paça sa malet!... Të kanë gënjer, o bir, të dhëntë zoti ymër të gjatë! Unë po iki se jam vonë...

— Ej! — u kujtua Malka. — Po gomarin të kujt e ke?

— Të një miku!

— Të ç'miku?

— Të një miku tim nga Sellca, — gënjeu Musai.

— Se, në paç gënjer njeri në fshatin tonë, do të kisha zbritur e do ta merrja...

— Jo... jo! larg qoftë! E kam nga Sellca, — përsëriti ai dhe e shpoi prapë në vithe gomarin. Ky mori një trok të nxituar dhe figura e gjatë e Musait u tund një copë herë mbi samar...

«Ku ishim gjer dje? — mendoi Malka. — Ja, tani, si ikën Musa efendiu dhe si ikën e tretet bashkë me të, në errësirë, edhe feja»...

Sërish iu kujtuan ato fjalët e sekretarit për «rrënjët e thella».

«Musa efendiu vjen pa gdhirë, në errësirë, dhe zhduket në mbrëmje, prapë në errësirë! Kjo do të thotë se asnjëri nuk ja shtroi në fshat, asnjë besnik më s'i mbet këtu! Ahere, ku i mbetën më rrënjë Musa efendiu?»

U err edhe më. Silueta e murme e «stërgut» humbi diku thellë... Atë sikur e përpiu vala e zezë e territ që mbulonte fushën. Malka dëgjoi shkumëzimim e potershëm të ujërave. I zbriti mushkës dhe e hoqi për kapistre nëpër urën prej thuprash. Në mes të urës, mezi dalloi një njeri, të ngarkuar me një krah shkarpa. Malka e arriu më të dalë të urës.

— Qënke ti, Brahim? Si u ngryste? — tha.

— Unë jam, o Malkë! Si ma ke qejfin ti?

— Pse je vonuar kaq shumë?

— E. e. e... mbusha patatet me dhe, — tha Brahim.

— Ç'je ngarkuar kështu, si gratë qëmoti? Ku e ke gomarin? — Brahim s'foli. Gurmazi i lëvizi poshtë e lart me zor, nga një e gëlltitur. E mbështeti barrën me shkarpa pas telave, nxori urorin e bëri të zerë një zjarr. Xixat ndriçuan fytyrën e tij të parruar. Malkës iu duk i plakur, i drobitur nga lodhja e nga mendimet.

— Po gomarin ku e paske sot?

— Na! ndize! — iu shmang edhe një herë përgjegjes Brahua.

— Unë të them ura, ti më thua ku do hedhim lumin. More! — i shkrepri Malkës në mëndje. — More Brahim! Po ti ja kishe dhënë gomarin hoxhës?

— E çë në ja dhashë? S'është njeri edhe ai?

— O Brahim, o mendjemykur! — thirri i nxehur Malka. Këtu në fshatin tonë rron ti apo në pyll me arinjte? A nuk ishe ti në mbledhje kur vendosi fshati ta zbojë Musa efendinë si gënjeshtar e maskara?

— E çë edhe në isha?

— A nuk e dëgjove ti të venë e Rushanit që thoshte se si e pat gënjyer hoxha me nuska, se si kish

vdekur djali i Rakipit se nuk e kish shpurë te doktori, se si...

— E çë edhe në i dëgjova? Mua s'më ka bërë ndonjë të keqe! Njeri nuk është edhe ai?

— Jo! Ai është pjavicë! Këpushë! Tani, po t'i bjerë kazmës, mund të fillojë të bëhet njeri si ti!

Brahua heshti. Edhe Malka heshti një hop. Ujërat e turbullta përplaseshin pas gurëve.

«Po bërtas! — mendoi Malka. — Nuk duhet ta bindësh tjetrin duke bërtitur!»

Brahimi bëri të marë shkarpat mbi shpinë.

— Ti, Braho, je si ato zhabat që rrinë në batakl! Nuk po shkon me rrjedhën e lumit, me rrymën që i përllan të gjitha!

— E? — tha Brahua — ç'thua?

«As kështu nuk bën! — tha Malka. Brahimi s'të kupton kështu». Brahimi mori udhën. Ecte ngadalë, shtrembër. Barra ishte e rëndë.

«Një anë gomari! — mendoi Malka.

— Brahim!

— E?!

— Leri shkarpat aty, t'i ngarkojmë në mushkë!

— Mirë!

U nisën në heshtje. Malka mendonte:

«Ja, Brahimi! Brahimi është si ai guri që ka dalë i mpirë nga dimri se ka rrojtur në vende gropa, nën ujëra. Musa efendi është uji për Brahimin. Ai i ka mpirë mendjen. Tani duhet diell, ajër, ngrohtësi! Duhet më shumë zgjuarësi, dashuri, fjalë e ngrohtë për Brahimin». — Vuri re se Brahimi trazonte pluhurin e rru-gës me një fshikull.

«Mendohet! Ç'mendon vallë Brahimi?»

— Brahim!

— E?!

— Si thua? Mirë apo keq bëre që ja dhe gomarin hoxhës dhe vetë u ngarkove me shkarpa?

— Ku e di unë?

— Ç'të mirë pate ti nga ai?

— Asgjë!

— Po kush pa të mirë nga këta njerëz, o Brahim?  
— S'e di!  
— Kur do ta kthejë gomarin?  
— Nesër!  
— Ç'do t'u thuash vajzave të tua, o Brahim?  
— Pse, vajzave do t'u jap hesap unë?  
— Po kur ta marrë vesh fshati, si do t'u ruhesh romuzeve?

Brahimi e flaku fshikullin.

— Lere! — tha. — Fshati do të më qesëndisë!  
Ndofta s'bëra mirë! A bën sikur mos të tregosh në fshat për punën e gomarit?

— Se mos ka rëndësi kjo, o Brahim? Rëndësi ka që ti të kuptosh se Musa efendiu nuk e ka hak atë që bëre ti, se ai, para teje që je një bujk i mirë, që ke vaditur me djersë këtë dhe, është si një këpushë, si një mormolec i ujit që të hyn në bark dhe të sjell dhëmbje!

— Ej! drëq! Sa ndorësh të vjen për nofka! Mormolec i thua tani! — qeshi Brahim.

Iu afruan fshatit.

«Do të më ketë gënjyer derri i derrit! — mendoi Brahim — S'besoj t'ja ketë paguar njeri hakun e mu-ajit, kurse mua më vuri krunde dhe vajta i dhashë gomarin! T'ja them se si më gënjeu këtij Malkës apo jo? ë?»

Brahimi, hëpërhë, heshtëte. Malka mendohej:

«Nuk mjafton të prishësh minarenë. Duhet shkukur një minare tjetër. Ajo ka lëshuar rrënjë në një qoshe të mykur të mendjes së brahimëve... Këtu të dua tani!».

*Nxjerrë nga gazeta DRITA, Nr. 27, 1967*

## NYJA E DJEGUR

Behija i mbylli dhitë në ahur, mbështolli rreth dorës litarin me të cilin kishte ngarkuar dushkun në shpinë, u drejtua për në dhomë, litarin e la mbrapa derës dhe u ul pranë vatrës që të ngrohet. Nënë Xhikja po bënte çarape me shtiza, kurse Dilja, nusja e të vëllait, gatua ante darkën. Drita e mekët e kandilit ngjante si një yll që mezi duket nëprmet shtresës së reve. Drutë në zjarr digjeshin duke kërcitur me zhurmë. Muret e rrahura nga tymi e bloza ishin nxirë. Merimangat vareshin si jargë kërmilli nëpër trarët.

Behija i shikonte këto, siç i kishte parë gjithë herët e tjera. Ajo kështu e mbante mend gjithmonë këtë dhomë, të gjithë shtëpinë. Gati edhe jeta e saj që po e njëjtë. Kujtime të ëmbla për të ishin vetëm ato të vegjëlisë, të jetës shkollore. Pastaj, mbasi kish mbaruar klasën e katërt, po i njëjti avaz: shko me dhi, ngarkou me dru e me dushk, thur fanella e çorape, gatua bukë e ziej fasule.

Një zë u dëgjua që jashtë nga shtegu. Ajo ndjeu hapat e vëllait të madh, Hamdiut, që doli menjëherë.

— Paj, kush thirri, e? — pyeti nën Xhikja me habi tek rrinte mbështetur pas murit në krye të vatrës.

— Ndonjë mik, dru — iu përgjegj Dilja.

— Jo, hej, se miku nuk ban za ka shtegu, po hyn drejt e në çardak.

U dëgjua zëri i Hamdiut që bisedonte me dikë, dëgjohej edhe një zë i hollë tingëllonjës, që nuk shëmbëllente me zë burri. Mbas pak u ndjenë hapat e vëllait të Behijes dhe hapa të tjera, pastaj përsëri u dë-

gjua ai zëri i hollë që pyeste dhe ai i Hamdiut, që, me sa dukej, diç përgjigjej. Dilja iu afrua derës dhe vuri syrin te një e çarë.

— Ndonji e delegueme, — tha nënë Xhikja pa lojtur nga vendi.

— Janë dy, — ja priti Dilja, që u kthye te vendi i saj për të trazuar fasulet në kusi me lugën e drunjtë. — Nga zani më duken si goca, megjithëse kishin pantolla, — shtoi.

Mbas këtyre fjalëve, në dhomën e grave ra heshtja: nga dhoma e burrave nisi të vinte gjer aty mërmëritja e mbytur e bisedës.

Behija u bë shumë kureshtare. U mundua të gjejë ndonjë shkak për t'iu afruar derës që të dëgjonte ato që thuheshin. Iu kujtua një nyjë në mes të litarit, e cila e kishte munduar gjatë ditës për ta zgjidhur. Ishte orvatur me thonj e me dhëmbë dhe, më në fund, e mërzitur, e kishte lënë. Tani kjo nyjë do t'i shërbente si shkas për t'iu afruar te dera që të përgjonte.

Puna e të dëgjuarit tinës në dhomën e burrave Behijes i qe bërë ves kohët e fundit. Grave u ndalohej vajtja atje kur kishte njerëz që s'ishin të shtëpisë. Në qoftë se i ardhuri do të qe ndonjë mik i njohur, ato mund të takoheshin me të, vetëm me urdhërin e të parit të familjes.

Por Behijes nuk i rrihej pa mësuar se kush vinte mysafir. Diçka e trondiste, i ndillte një lloj frike kur në shtëpi kish miq. Mos kishin ardhur nga ana e?...

— Pse u ngute me e zgjidhë nyjën, Behije; apo ke frikë se t'u ka lidh fati a? — e ngacmoi Dilja.

— Mos e luej gocën, nuse! — e qortoi e vjehrra.

Behija u zemërua shumë nga shpotia e së kumatës. Sa herë i kujtonin «fatin» e saj, dëshpërohej shumë.

Pikërisht, shkaku i këtij «fati» e kishte shtyrë Behijen kohët e fundit që të përgjonte. Dhe ky «fati» i Behijes kishte një histori më vete.

... Atëherë ajo kishte qenë gjashtë vjeçe. E kalonte kohën duke luajtur me fëmijët e mëhallës, gëzohej kur i plotësoheshin teket e saj, kur i blenin ndo-

një palë dimite të reja; qante kur rrëzohej dhe vriste gishtërinjtë në ndonjë gur, kur i flisnin për ndonjë faj, apo kur i hiqnin ndonjë pëllëmbë. Ishte shumë çapkëne dhe e afruar, sa që i ulej në prehër pa u ndrojtur, kujtdo që vinte në shtëpinë e tyre. Ashtu ish ulur ajo edhe në prehrin e Musa Belikut, që kishte ardhur nga fshati fqinj. E ku e dinte e gjora fëmijë, se tamam ajo sjellje fëminore do ta «lidhte» jetën e saj? Atë mbrëmje, ndërsa Behija fërkonte duart leshtore të mikut me doçkat e saja të njoma qumësht, mysafirit i shkrepri në mendje ta bëjë këtë «keçe» nuse të djalit të tij. I shkrepri në mendje, e kërkoi dhe e mori fjalën. Për këtë «keçe» gjashtëvjeçare, Musa Beliku i numëroi atit të Behijes, Mersinit, njëzet e pesë mijë lekë.

Mbas një viti Behija hyri në shkollë. Kujdesi i mësueses dhe dëshira që kish për të mësuar e futën në botën e këndshme të librave dhe të ëndrrave të bukura fëminore.

— Ju do të rriteni të lumtur, — u thoshte mësuesja. — Për ju nuk do të ketë më vuajtje, ashtu siç ka pasur për prindërit tuaj.

Dhe Behija ndjehej me të vërtetë e lumtur. Ajo e parafytyronte veten e saj të rritur, mësuese me fëmijët, që i mblidheshin për rreth me respekt e dashuri. Ajo do t'u mësonte abetaren dhe ata do t'ja përpinin nga goja fjalët.

Por, si mbaroi shkollën fillore, jeta për Behijen mori një kthesë.

— Tashti u bane goxha gocë; prandej duhet me u nda nga shkolla se je e fejueme, — i thanë.

Dhe ajo, ndonëse kishte shumë dëshirë të vazhonte shkollën, bëri siç e urdhëruan.

Dalngadalë, duke u rritur, zuri të mendojë për të fejuarin e saj. Kishte dëgjuar se quhej Pëllumb Beliku. Emri Pëllumb i pëlqente shumë. «Po çfarë njeriu ka me qenë ky Pëllumbi?» thoshte, dhe një ndjenjë e huaj, e largët, e frikshme ja pushtonte krahërorin. Një «pëllumb» që nuk ka të bajë aspak me mue...

Kaluan vite. Moshataret e saj u martuan njera

mbas tjetrës, por për Behijen s'po dukej asnjë njeri nga ana e dhëndrrit për të prerë ditën e dasmës. Njerëzit filluan ta shikonin me dyshim dhe vajza ulte sytë e turpëruar, ndërsa zemra i ndrydhej në krahëror.

Një ditë i ati u bë si i tërbuar. Vinte vërdallë nëpër shtëpi dhe shante e bërtiste, duke përmendur herëmbashere emrin e Pëllumb Belikut.

E kunata i pëshpëriti Behijes se dhëndrri kish lajmëruar me një letër se krushqia ndërmjet tyre qe prishur. «Unë jam anëtar i bashkimit të rinisë, thuhej në letër, dhe jam kundra mënyrës si më fejuan kur isha kalama. Merreni me mend se ç'bashkëshortë do të jemi unë dhe Behija, deri sa nuk e kemi parë të paktën një herë njeri-tjetrin. Unë e di se juve, pleqve, do t'ju vijë rëndë nga ky veprimi im, por Behija besoj se do të më kuptojë drejt e nuk do t'i ngelet hatri. Sa për paratë që kini marrë nga im atë, as që mos u bëni merak, ju bëfshin mirë dhe qofshi të gëzuar».

Behija vështroi për disa çaste e habitur kunatën, pastaj uli sytë pa qenë në gjendje të mendojë gjë. Nuk dinte as vetë ç'ndjente. Më tepër se dhimbje, atë e pudingtoi një ndjenjë turpi, turpi që do të quhej vajzë e braktisur. Por thellë në shpirt i bëhej se Pëllumbi e kish shpëtuar nga një ankth, që e mbërthente sa herë mendonte për martesën e saj, për fatin e saj në shtëpinë e burrit. Ajo u mërzit pak, po kjo ndjenjë i kaloi. Ajo u çlirua nga një barrë e rëndë. Asnjë gjurmë dashurie nuk kishte në shpirtin e saj dhe lëndimi i ndër-gjegjes do të shuhej shpejt. Vetëm i ati shpërthente si furtunë, ja shfrynte inatin kujt të mundte dhe pinte tre kuti duhan në ditë. I vëllai i madh, Hamdiu, e kërcënonte atë që u lëshoi këtë turp në shtëpinë e tyre. Ndryshe qëndronte puna me vëllanë e vogël, Besimin. Ai e quante me vend veprimin e Pëllumbit. Nënë Xhikës i bëhej zemra copë dhe nuk guxonte të dilte në sytë mëhallës, kur mendonte se, mbas kësaj, vajza do t'i mbetej në shtëpi. Kurse e kunata herëmbashere e tërthorazi ja ngulte ndonjë thumb.

...Nyja e litarit i mbeti në dorë Behijes, atje tek



rrinte prapa derës. Ajo e shtypte ngadalë me gishtërinj, sikur të prekte ndonjë dhëmballë të sëmurë. E tërhoqi biseda që zhvillohej në dhomën e burrave ndërmjet të zotërve të shtëpisë dhe dy vajzave që kishin ardhur mysafire. Dëgjoi se njëra nga vajzat quhej Shpresa dhe tjetra Burbuqe, se ato kishin ardhur së bashku me njëzet e tetë shokë dhe shoqe të tjera, që të punonin pesëmbëdhjetë ditë për të ndihmuar për hapjen e tokave të reja të kooperativës së re malcre.

Ja kish ënda të takohesh me shoqet e ardhura nga qyteti, por druhej se mos i bërtiste i ati. Megjithëse nuk njihte asnjërin prej tyre, nga fjalët që fliste, i pëlqeu më shumë Burbuqja. Ajo fliste në atë mënyrë, sa që Behijes i dukej sikur ishte në zemrën e saj, në zemrën e vajzës fshatare. Muhabeti që kish nisur me problemet e kooperativës së re, kish kaluar te lufta për zhdukjen e mbeturinave fetare e zakoneve prapanike, dhe të atyre zakoneve të këqia që e kishin lënë gruan dhe vajzën prapa. Xha Mersini dhe Hamdiu ngulnin këmbë për zakonet, por vajzat, sidomos ajo Burbuqja, me dy fjalë i bënte që t'u vinte gjuha vërdallë nëpër gojë. Edhe Besimi më të rrallë lëshonte nga një fjalë, ashtu si pa dashje, veçse ato fjalë zemëronin të atin dhe Hamdiun, ndërsa vajzat vinin buzën në gaz dhe i jepnin të drejtë.

— Këtej e tutje — tingëlloi zëri i Burbuqes — gratë nuk do të jenë më skllave të këtyre zakoneve. E tërë Shqipëria me fjalën e Partisë në zemër, është ngritur në këmbë, t'i djegë ato rregulla që marrin nëpër këmbë të drejtat e grave dhe të vajzave. Janë ngritur gjer pleqtë e malësive të largëta. Kudo... — Ajo deshi të shton-te edhe diçka tjetër, por në dhomën e grave u ndjenë hapat e Diles. U hap dera dhe u duk gjysma e tepsisë me bukën e gjellën e darkës. Kështu ishte zakoni: njëra nga gratë e sjell bukën deri te dera, pastaj ngrihet njëri nga burrat dhe e shtron në sofër.

— Ecë, oj nuse, mos ki turp se edhe këto shoqe si ty janë; ani se kanë veshë pantallona; — i foli Besimi së kumatës, pa u merakosur nga vështrimet e zemëruara të plakut se po thyhej zakoni.

Dilja u mat të hynte por u pendua në çast. Që ta bënte atë duhej fjala e vjehrrit. Burbuqja u ngrit menjëherë dhe iu afrua derës.

— Nga ne druhesh, moj motër? — i dha zemër Diles, që qëndronte me tepsi në dorë.

— Ja, ... kështu, kështu e ka zakoni, — iu përgjegj ajo gati me një psherëtimë.

— Çfarë zakoni, moj!? Ne do t'i hedhim në kosh të gjitha këto mbeturina që na kanë ngatërruar këmbët, — ja priti Burbuqja rrëmbyeshëm e gati-gati si me qortim.

Dilja, e nxitur nga fjalët dhe vështrimet e mysafires, kaloi prakun e derës. Dera mbeti e hapur. Burbuqja hodhi sytë matanë. Prapa kanatit dalloi Behijen, që në atë çast rrinte si e hutuar me litarin në dorë tek shtrëngonte me gishtërinjtë nyjen. Në gjysmëerrësirë, mysafirja vuri re tiparet e bukura të malësORES. Drita e kandilit nga dhoma e grave dhe ajo e llambës me vajguri nga dhoma e burrave ndesheshin në faqet e saj të shëndetshme, në ngjyrë trëndafili. Burbuqja deshi t'i thosh ndonjë fjalë, e zuri për dore, e tërhoqi pas vetes dhe iu kthye shoqes së saj:

— Shpresë, shiko ç'thëllënzë gjeta. Rrinte te dera dhe nuk guxonte të vijë tek ne. Po këtë litar pse e mban në dorë? — iu drejtua Behijes.

— Desha me zgjidhë nyjen, por nuk mujta...

— Nyjen, ë? — Burbuqja vuri buzën në gaz. Ajo kish dëgjuar për bestytninë e nyjes, për «fatin». Por, duke parë litarin në dorën e malësORES, atë litar që ishte bërë pjesë e pandarë e jetës së vajzës dhe të gruas, e jetës së rëndë, menjëherë sytë i shkrepëtinë.

— Nuk e zgjidhë dot? — përsëriti. — Mirë, ma jep mua. Kjo nyje duhet djegur në zjarr.

Burbuqja mori për nga vatra, me fytyrën të ndezur.

— Mos, se nesër i duhet litari përsëri, — kërcëu Hamdiu.

— Nuk do t'i duhet se s'ka për t'u ngarkuar më, — u përgjegj e vendosur Burbuqja dhe, ndërsa nderi

dorën për ta hedhur në zjarr, shtoi: — I ndarë më dysh litari do të jetë më i volitshëm për kafshët e shtëpisë.

— Buqe, prit një minutë, — e ndaloi Shpresa. — Ta djegë vajza me dorën e saj.

— Shumë mirë; — Burbuqja i zgjati litarin Behijes; —merre dhe përvëloja kokën, nxirrja inatin që të ka mbajtur lidhur kaq kohë.

E tërhequr nga tërë kjo lëvizje e gjallëri, në derë u duk nënë Xhikja me shtizat dhe lëmshin e penjëve ndër duar.

Sytë e të gjithëve u mbërthyen te duart e Behijes. Ajo e mbante litarin sikur të kishte mbërthyer qafën e një gjarpëri. Sofra e shtruar në mes të dhomës u harrua.

Behijes i erdhën si të papritura të gjitha sa po ngjisinin. Sytë dhe mendimet e saj të shkëputura u mpleksën te nyja e mallëkuar. Po të kishte biseduar Burbuqja më parë me të, po të kishte biseduar veçan me të, ndofta do të kish pasur më shumë guxim, por tani, ashtu papritur, si t'ja bënte?

Plaku trazonte zjarrin duke turfulluar. Hamdiu vështronte me inat mysafiret, herë gruan, herë motrën. Vetëm Besimi, që s'po ja ndante sytë Behijes, e shihte me dashuri e dukej sikur i thoshte: Jepi, motër, jepi Behije!

Behija nuk po vendoste dot. Donte ta flakte në zjarr atë nyje, por tek vështronte të atin që turfullonte, tërhiqej. I vinte inat me veten e saj që nuk kish guxim, atë guxim me të cilin, vëllai i vogël dhe shoqet e fshatit i kishin treguar se, shumë të reja të Shqipërisë po shkelmonin zakonet e këqia.

— Digje, mos u lëkund! — tingëlloi përsëri zëri i Burbuqes. — Sot e ka radhën litari, nesër veshja... — dhe mysafirja preku brekushet e malësorës.

— Oj gocë, — foli papritur xha Mersini me vetulla të ulura. — Ke ardhë mysafire dhe rri ashtu siç duhet!

— Mos u rrëmbe, xha Mersin, — ndërhyri Shpresa. — Ne biseduam edhe më parë rreth këtyre gjërave.

Ti vetë the se ke dëgjuar se ç'po bëhet në Shqipëri. Mos vallë prindët e tjerë nuk i duan fëmijët e tyre, nuk e duan nderin e shtëpisë, kur vendosin të heqin dorë nga zakonet e këqia? Apo pandeh ti se Partia, duke na porositur për këto gjëra, nuk mendon më për të mirën e popullit, për përparimin e vendit? Partia...

— Partinë mos e ze në gojë, — ja preu fjalën plaku. Ai deshi të thoshte akoma diçka, por, si duket, nuk i gjente dot fjalët, sepse e la përgjysmë dhe filloi përsëri të trazojë zjarrin, të ngatërrojë urët, të hedhë shkarpa të tjera. Zjarri mori flakë. Flakët nisën të ngrihen lart. E mbi flakët ra nyja e litarit. Një çast më vonë litari i shtrirë në dhomë qe ndarë më dysh. Burbuqja kish përqafuar Behijen, nënë Xhikja po shikonte nga sofa.

Atë natë, rrotull sofrës, u ulën të gjithë të hanë darkë.

*Nxjerrë nga gazeta DRITA, Nr. 25, 1967*

LINDJA E PARË

Shtëpia e lindjes u hap në fillim të vjeshtës. Ishte një ndërtesë e thjeshtë me tri të ndara, njera prej të cilave do të bëhej «dhoma e lindjes». E ngritën afër qendrës së fshatit. Në një krah ishin zyrat e kryesisë së kooperativës, në krahun tjetër depot e drithit.

Kur e mori vesh këtë gjë magazinieri Uk Gjeta, një beqar i moçëm, që. njihej në tërë fshatin për gjuhën e helmatisur, tha me atë zërin e hollë që kanë zakonisht qoset:

— Hë ç'do të shohim tajatro tashti e tutje!

Përveç mamisë që pritej të vinte nga qyteti, kryesia vendosi që atje të punonte Mara, një plakë e ve, që rronte fillkat, pasi dy vajzat i kishte martuar.

— Në fillim do t'u vijë zor, por pastaj do të mësohen — tha kryetari.

— Po ti e di si janë gratë e fshatit tonë, shoku kryetar; mos harro se ato. përpara, kur u vinte koha për të lindur, shkonin në pyll dhe atje e nxirrnin fëmijën në dritë.

— E di, edhe unë vetë atje kam lindur, — tha kryetari me një buzëqeshje të hidhur. — Kjo ndodhte para çlirimit, kurse sot gratë lindin nëpër shtëpitë e lindjes.

Të nesërmen, megjithëse pa qejf, Mara shkoi në shtëpinë e re dhe nisi ta lajë e ta pastrojë. Pas një jave erdhi mamia. Quhej Sulltane. Kishte një trup të ngjallur, të flashkët, fytyrë të rrumbullakët dhe dy sy me një ngjyrë të papërcaktuar e fare pa jetë.

Kaluan ditë. Mara mori vesh se gjatë atyre ditë-

ve dy gra kishin lindur në shtëpi. Ja tha këtë gjë Sulltanës, por ajo nuk foli fare, vetëm ngriti supet.

Ditët që erdhën, nuk sollën asnjë ndryshim. Asnjë grua nuk shkeli në shtëpinë e lindjes. Çarçafët e shtretërve rrinin të paprekur. Edhe ilaçet nuk ishin hapur fare. «Dhoma e lindjes» ende nuk kishte dëgjuar zërin e ndonjë foshnjeje. Ajo shtëpi e ngritur në mes të fshatit ishte i heshtur si një vend i pabanuar dhe në oborrin e saj luanin gjethet e thara që binin nga pemët si flutura të verdha.

Por nga fundi i shtatorit çdo gjë ndryshoi papritmas. Kjo ndodhi një të hënë. Në fshat u kthyen tri vajza që kishin qenë në hekurudhë me brigadën e të rejavave të krahinës. Në mes të tyre ishte edhe Filja, sekretarja e rinisë së fshatit. Ajo njihej nga të gjithë si vajzë e shkathët, e papërtuar, shpuzë e gjallë. Kur ishte fjala për rininë, e sidomos për çështjen e grave, Filja luftonte me të gjitha forcat dhe grindej me burrat dhe me vetë kryetarin e kooperativës, po ta lypte nevoja.

Kishin rënë shirat e para e moti që ftohur. Gjethet e rëna loznin prapë të qeta në oborrin e shtëpisë së lindjes, e cila ishte gjithmonë e heshtur ashtu si përpara.

Files nuk i rrihej në vend; pranë shtëpisë së saj rrinte familja e Lazër Mhillit dhe pritej ato ditë që nusja e djalit të tij të lindte. Filja shkonte shpesh aty, ndonëse plaku Lazër, që para pak vitesh kishte qenë shërbëtor i priftit, njeri i ashpër e fanatik i madh, nuk i shihte me sy të mirë vizitat e sekretares së rinisë.

Megjithatë Filja nuk epej dhe prapë përpiquej. Ajo e dinte se ishte puna sa të thyhej akulli, të shkonte atje gruaja e parë për të lindur se pastaj do ta kishin më lehtë.

Një ditë me shi Filja mbaroi punën dhe u kthye në shtëpi. Ishte pasdite vonë dhe hijet e para të muzgut po shtriheshin ngadalë. Ajo hëngri bukë, këmbëu disa fjalë me të ëmën dhe u nis për në shtëpinë e Lazër Mhillit.

Të parin takoi plakun. Filja vuri re si ai u shqet-

tësua porsa e pa, bile kjo e bëri të mendojë se diçka kishte ngjarë.

— Si është Dila? — pyeti ajo menjëherë duke i mëshuar zërit.

— Si kokrra e mollës.

— Më lerë të shkoj ta pyes vetë.

— Nuk është në shtëpi.

— Po ku është?

Plaku u ngrys në fytyrë dhe u përgjegj me zë të lehtë:

— Tek e ëma.

Filja nuk i tha gjë por u largua me vrap. Dilen nuk e gjeti në shtëpinë e së ëmës. Padashur i kaluan mornica nëpër trupin dhe një pikëllim i madh i rëndoi në zemër:

— «Në pyll» tha me vete. Hodhi sytë dhe pa pyllin. Ai ishte i heshtur, i zi, dhe mbi të retë e ulëta shtrydhnin një shi të imët e të mërzitshëm.

Po kjo zgjati vetëm një çast. Filja u shkund dhe u nis drejt pyllit gati me vrap. Këmbët i binin nëpër gropa të mbushura me ujë, nëpër fytyrë e nëpër tesha i rridhnin pikat e shiut. Ecte dhe mendjen e kishte tek Dila. Nuk donte të vonohej. Çdo çast ishte i çmuar. Ajo duhej të arrinte me kohë, duhej ta ndihmonte nusen e re, ta bindte e ta merrte me vete.

Kur mbriti në prak të pyllit, u ndal. Ja, tani ishin përballë njera-tjetrit ajo dhe pylli i errët, i lashtë, i ngrysur. Aty brenda tij, gratë kishin pjellë fëmijët, aty njerëzit e bajraktarit i kishin vrarë babanë në pritë, aty ishin fshehur në vitet e para të pasçlirimit diver santët dhe gjakësorët. Dhe, tani, ishin përballë njera-tjetrit ajo dhe pylli. Mendoj një çast nga të drejtohej, pastaj u fut me guxim brenda hijeve. Me sa kishte dëgjuar nga gratë e moshuara, shtatzënat lindnin në një cep të mënjanuar, ku ishin disa gëmusha të larta e të dëndura. Ajo nuk e dinte me përpikmëri ku ndodhej ai cep, por do ta gjente, duhej ta gjente medoemos. Pasi eci disa kohë, nisi t'i thërrasë Diles. Moti vinte duke u keqësuar. Shpesh errësirën e shqyente shpata

e ndritur e ndonjë rrufeje, kurse thirrjet e saja i mbulonte gjëmimi i përsëritur i bubullimave.

Ajo vazhdonte të ecte, të kërkonte. Tek qëndroi një çast për të hequr një drizë që iu ngatërrua pas fustanit, iu duk sikur dëgjoji një zë. Mbajti vesh. Asgjë. Ashtu i ishte dukur. Atë çast stuhia ishte qetësuar dhe dëgjoheshin vetëm pikat e shiut që binin nga degët e lagura. Ajo nuk lëvizi. Ja, prapë një zë. U gjallërua menjëherë dhe zemra i rrahu. U nis andej nga vinte zëri. Pas pak dëgjoji edhe një herë zërin që ankohej. Tani nuk kishte më asnjë dyshim. Thirri:

— Dilë!

Ju duk sikur lëvizi diçka aty përpara.

— Dilë, mos u tremb, jam unë, Filja.

Eci edhe pak dhe u gjend pranë nuses së re.

— Çfarë do? — i tha Dila.

Ajo nuk u përgjegj, por e pyeti:

— Si e ndjen veten, Dilë, a mbahesh?

Nusja nuk foli. Heshtje. Dëgjohesh vetëm ndonjë pikë e vonuar shiu që zbriste nga degët.

— Çfarë bën këtu, Dilë? — Por e ndjeu se pyetja nuk kishte kuptim dhe shtoi: — Pse kështu, motër? Pse këtu?

Atëhere Dila, me fjalë të pakta, i tregoi si kishte qenë puna. Asaj i kishin filluar dhimbjet nga dreka. Në fillim ishte përmbajtur, por pastaj nuk kishte duruar dhe kishte thirrur. Atëhere plaku kishte hyrë në dhomë, e kishte shikuar me inat. Diles së gjorë sikur i kishte rënë shtëpia mbi kokë. Vjehrrri u largua dhe, duke dalë, i la dy dyert e shtëpisë të hapura sikur donte t'i thotë: «Dil prej këndej dhe shko e lind atje ku lindnin gratë përpara, atje ku duhet të lindë çdo grua sipas kanunit». Atëhere ajo ishte ngritur dhe, duke përmbajtur me zor dhimbjet, kishte ardhur e vetme deri aty. Po bënte tri orë që ishte në pyll.

Files përbrenda i ziente një zemërim i madh, por përmbahej dhe nuk fliste. E kuptonte se duhej të kishte shumë kujdes, të sillej mirë me gruan shtatzënë, por edhe të ishte e vendosur deri në fund për t'ja arrihur qëllimit.



— Nuk duhet të rrish këtu, — i tha pas pak me zë të butë. — Në pyll bën ftohtë dhe ka lagështirë. Kështu mund të marrësh në qafë veten dhe foshnjën. Eja me mua.

— Ikë, — tha ajo me gjysmë zëri.

— Nuk iki. Ti do të vish me mua.

Dhe duke thënë këto fjalë i zuri dorën. Dila u drodh, heshti një çast, pastaj tha me zë të lehtë:

— Nuk vij.

— Do të vish. Kjo është për të mirën tënde dhe të gjithë grave të tjera. Eja, motër.

Ecën disa hapa. Dila i hidhte këmbët ngadalë. Pas pak qëndroi dhe tha:

— Nuk vij. Është turp i madh. Kur ta marrin vesh...

— Çfarë turpi, Dilë? Turp të pjellësh fëmijë? Eja, Dilë. Këtu bën ftohtë.

U dëgjua një bubullimë e fortë. Pylli ushtoi. Pas pak nisën të trokasin përsëri pikat e shiut. Një vetëtimë shqeu errësirën. Filja shikoi fytyrën e Diles: ajo ishte e bardhë, pa asnjë pikë gjaku në fytyrë. Sytë i kishte të zmadhuar dhe buzët e shngjyrosura i mbante të puthitura fort. Filës iu drodh zemra kur e pa. Filluan të ecin më shpejt. Shiu u shpeshua. Pylli ishte i heshtur, i zymtë.

— Më ngadalë, — thirri Dila.

Qëndruan. Nusja merrte frymë me vështirësi.

— Mbaju, Dilë. Edhe pak do të mbrijmë, — e nxiti Filja dhe nisën të ecin përsëri.

Kur dolën ndanë pyllit, Dila prapë qëndroi dhe e pyeti shoqen:

— Ku do të më çosh?

— Në shtëpinë e lindjes.

— Atje nuk vij.

— Do të vish.

— Deri tani atje nuk ka shkelur asnjë grua e katundit.

— Nuk prish punë. Do të pjellësh ti e para.

Ajo vijoi të kundërshtonte, por Filja nuk e zgjati.

Kur mbërritën para shtëpisë së lindjes, Filja trokiti me sa fuqi kishte. Nga brenda nuk dëgjohej asnjë zhurmë, asnjë zë. Ajo trokiti prapë. Pas disa çastesh, u dëgjua një zë i trembur:

— Kush është?

— Hape shpejt, jam unë, Filja.

Mamia pëshpëriti diçka me vete dhe hapi derën. Në dritën e kandilit u duk fytyra e përgjumur e Sulltanës.

— Pregatitu për lindje — tha Filja dhe e shtiu Dilen brenda. Sulltana në fillim nuk u besoi syve, por pastaj nisi të gjallërohet pak dhe e çoi gruan shtatzënë në dhomën e lindjes.

Filja qëndroi në dhomën tjetër. Ishte e shqetësuar sepse Sulltana i tha se lindja që e vështirë. Sillej nëpër dhomë, pastaj qëndronte e mbante vesh. Mendonte pa-reshtur për Dilën. Sikur asaj ose foshnjës t'i ndodhte gjë, kjo do të thoshte ta mbyllje shtëpinë e lindjes.

Ndaj të gdhirë, mamia hyri në dhomën ku rrinte Filja dhe i tha: — Djalë! — Filja gati sa nuk e përqafoi nga gëzimi. Mori frymë e lehtësuar dhe shkoi te Dila. Ajo ishte e shtrirë me fytyrën më të bardhë se çarçafët. Sytë i mbante të mbyllur. Dukej e qetë dhe në buzët e saj, paksa të hapura, endej një buzëqeshje e lehtë. Pranë shtratit rrinte foshnja që qante e çirrej me zërin e saj të hollë por të fuqishëm.

Filja qëndroi disa kohë pa hapur gojë, pastaj i tha Sulltanës:

— Hapi dritaret! Gjithë katundi ta dëgjojë zërin e banorit tonë të ri. Veç kësaj, ta marrin vesh të gjithë se u çel shtëpia e lindjes, se në të u bë lindja e parë. Hapi dritaret!

*Nxjerrë nga gazeta DRITA Nr. 36, 1967*

PAS MARTESËS

Ishte një nga ditët e fundit të muajit janar, a ndoshta dita e fundit. Dritaret e dhomës zbardhëllonin nga drita mëngjezore me një vezullim të përhimët. Zarja kish kohë të ishte zgjuar dhe, pa bërë asnjë lëvizje, kundronte me dashuri fytyrën e Ademit që flinte ende. S'i gëzohej dot të shoqit. E kish pritur me ankth çastin kur do të zgjohej një mëngjes së bashku me të. Përkëdhelte me sy kaçurrelat e tij, qepallat e puthitura, buzët pakëz të hapura dhe përsëriste me vete:

— Jam e lumtur!

Pikërisht në këtë çast dëgjoji prapa derës kollën e thellë të vjehrrit dhe zërin e tij të ngjirur e qortonjës:

— S'qenka ngritur nusja jonë?!

Zarja, duke ndjerë rreptësinë e zërit, u ngrit nga shtrati me kujdes që të mos ja prishte gjumin Ademit, u vesh shpejt e shpejt dhe në majë të gishtave doli nga dhoma.

Plaku që priste te dera, pa e vështruar, i bëri me kokë nga oborri dhe tha:

— Lësho pulat dhe hidhi lopës të hajë.

Zarja e kuptoi se ky ishte një urdhër i prerë, një zakon i vjetër me anën e të cilit provonin nusët. Plaku mund t'i bënte vetë këto punë, siç i kish bërë çdo mëngjes, por, me sa duket, deshi të provonte se sa e bindur e punëtore ish nusja e të birit.

Zarja u sul te koteci; pastaj rrëmbeu nga mullari një krah me jonxhë të thatë dhe hyri në ahur. Plaku

që nga çardhaku tundi kokën i kënaqur. Po kur Zarja doli në oborr, u ngrys menjëherë.

— Kafënë! — urdhëroi ai.

Dhe, duke pirë kafënë, i tha së resë pa e vështruar në sy.

— Shko, shko çlodhu edhe ca.

Zarja, e bindur si një shqerkëz, u kthye në dhomën e gjumit. Dhe menjëherë ndjeu një boshllëk në zemër. I fluturoi ndjenja flatraartë e lumturisë që kish ndjerë pak më parë. Ulur në fund të shtratit, ku flinte i shoqi, priste mos dëgjonte përsëri urdhërat e rrepta të vjehrrit.

Pas një jave ndodhi një gjë e papritur. Zarja, tërë gëzim, hodhi kazmën në sup. Te dera e shtëpisë i doli përpara plaku dhe e pyeti:

— Ku shkon?

— Në rrah... në brigadë.

— Ktheu — e urdhëroi ai dhe, si e pa vëngër, vazhdoi. — Nuset qëndrojnë një vit në shtëpi.

— Baba... — ajo donte t'i thoshte se ishte marrë vesh me Ademin, po plaku i preu fjalën:

— Zakonet nuk do t'i prish unë. Pas një viti shohim e bëjmë.

Zarja iu bind urdhërit me zemër të thyer. Nuk donte të fuste grindjen në atë shtëpi midis vjehrrit e burrit. Po e ndjeu veten sikur kish hyrë në një botë të huaj, që e ndante me mur nga puna e brigadës.

Dhe kështu filloi për të jeta brenda katër mureve, brenda gardhit që rrethonte oborrin. Asaj i zinte dora çdo gjë, punonte kopshtin me bel, kujdesej për ushqimin e lopës, spërndrite shtëpinë dhe priste me gëzim mbrëmjen kur kthehej Ademi nga puna. Po, dalngadalë, me kalimin e kohës, muret e shtëpisë u ngushtuan aq tepër, sa ajo filloi të venitej si bima në vllanjë të mbyllur.

Një pasdite po vinte duhan. Ishte fillka vetëm dhe vesa e shiut i lagte shaminë e kokës. Në ugar e në shtëpi kish pllakosur heshtja. Gjer afër mbrëmjes mezi mbollli dy brazda dhe me asnjëri nuk këmbëu një fjalë. Dhe

iu kujtua skuadra e saj, kur mbillte duhan. E fillonin punën pa dalë dielli dhe gjer në mbrëmje mbillnin tre dynymë. Puna kishte duk dhe koha kalonte pa u ndjerë. Vajzat, të nxehura nga puna, zukatnin nëpër ara si bletët dhe përpiqeshin kush e kush t'ja kalonte njëra-tjetrës. Në pushimin e drekës kërcisnin shakatë dhe muhabeti; lexonin gazetën, thurnin çorape e trikko, gjithë duke qeshur, gjithë duke vetëtirë nga gëzimi, sikur s'kish vajza më të lumtura se ato; më të lumtura se Zarja që i drejtonte. Dhe kur perëndonte dielli, s'u bënte zemra të ktheheshin në shtëpi. Duhani mbillet mirë mbrëmjeve, gjer vonë. Prandaj ato s'largoheshin nga ara, pa mbjellë tre dynymët. Vetëm kur ngrysej, ato ktheheshin dhe udhët e fshatit zienin nga bisedat e zjarrta, nga shakatë, nga këngët, sikur ish ndonjë ditë e shënuar.

Zares iu kujtuan këto dhe iu drodh zemra nga vetëmia. Ugari i shtëpisë, i rrethuar me gardh, iu duk si një kafaz dhe e ndjeu veten të dërmuar. Ndjeu edhe një brengë të madhe. Ademi, që gjer dje këshillohej me të për punët e brigadës, filloi të mos e pyesë më. Zares i dukej sikur ai ishte larguar prej saj, megjithëse sillej si më parë, i dashur e fjalëmbël. Po këto fjalë me kohë u rralluan. Ai s'kish ç't'i thosh më. Ajo s'dinte ç'të thoshte. Po i fliste gjithnjë për kopshtin, për lopën, për enët. Ai, i mërzhitur ndoshta nga këto biseda, kriste e ikte në klub, në kryesi, në mbledhjet.

Zarja i jepte të drejtë. I shoqi kish punët e kooperativës. Punët e saj nuk kapërxejin prakun e shtëpisë. Ademi s'kish përse të kërkonte ndihmën e saj. Këtë ndihmë ai e merrte nga tjetërkush, ndoshta edhe nga ndonjë grua që punonte a drejtonte në brigadë.

Një mbrëmje, asaj s'iu durua e i tha:

— Adem! S'qëndroj më në shtëpi. Do të dal në brigadë.

Ai e vështroi i habitur.

— Po babai thotë...

— Lëre ç'thotë babai! Këtu po më pëlqet shpirti. Çdo gjë më mbyl, më ndrydh, më poshtëron.

M'u neverit vetja, jam ndarë nga brigada, nga puna.

— Punë ke boll edhe këtu...

— Kam, po s'ndjej asnjë gëzim. Kjo punë më dërrmon. Jam katandisur si mos më keq. Më mbulon të qarët kur kujtoj skuadrën që drejtoja, spartakiadën ku dilja e para në vrapim, ansamblin ku këndoja si soliste. S'duroj dot më, Adem. Më ndihmo.

— S'kemi ç'ti bëjmë babait!

Ai mblodhi supet dhe doli si pa gjë të keq. Ky qëndrim i rëndoi Zares si gur në zemër. E ndjeu veten të fyer e të përbuzur dhe furka i ngriu në dorë. Por ajo ndjeu atë çast se në shpirtin dhe mendjen e saj ishte pjekur më në fund një vendim i prerë: nuk duhej t'u nënshtrohej zakoneve të mykura të së kaluarës! Nuk duhej! Në asnjë mënyrë, nuk duhej!

Ishte ulur mbi shtrat me furkën në dorë. Mbi dyshemenë që porsa e kish fërkuar me leckë të lagur, shkëlqenin njolla drite elektriku. Një tufë manushaqe, që kish mblodhur rrëzë ferrave të gardhit, kishin ulur kryet në kavanozin me ujë. Muret ndrisnin nga bardhësia. Në çdo qoshe të dhomës ndjehej dora e padukshme dhe e kujdesshme e amvisës së re. Po amvisa s'e kish mendjen aty. Ajo mendonte Ademin. E donte. Ai ishte njeri i mirë, punëtor, zemërbardhë. Mendonte Ademin dhe pika loti binin mbi furkën që i kish ngrirë në dorë.

Të nesërmen u ngrit pa gëdhirë, hodhi kazmën në sup e doli në oborr. Vjehri, ky babaxhan që u ngjallte respekt të tjerëve me heshtjen e tij, vetëm u kollit. Po nusja e re që e kuptonte domethënjen e egër të kësaj kolle, eci përmes oborrit. Kur arriti te praku, dëgjoji prapa krahëve zërin e tij të ngjirur:

— Ku vete?

Zarja u trondit në fillim. Pastaj mblodhi veten e u përgjegj:

— Në brigadë, baba!

— Ktheu! — urdhëroi plaku.

— Nuk kthehem, baba! — tha Zarja e vendosur.

— Ahere... mos u duk më këtu. Këput qafën! — thirri plaku.

Zarja e pa tek vinte drejt me hap të shpejtuar e me shkopin ngritur lart.

— Baba! — tha ajo, duke buzëqeshur hidhur. — Po s'më desh yt bir, nuk vij më në këtë shtëpi; prandaj mos m'u kërcëno, se nuk më trëmb me kërcënime.

Plaku bëri edhe një hap drejt saj, duke u dridhur prej zëmërimit.

— Ti ke hall mos të të dalë nami i keq — vazhdoi Zarja e qetë dhe si e vrarë. — Ke hall thashethemet. Po e ke gabim, baba. Ti nuk e kupton dëmin që po më sjell mua, Ademit, vetes... E di që një ditë do t'i braktisëh këto zakone, por ahëre ndoshta do të jetë vonë...

Vjehrrit iu errësuan sytë. Shkopi i ngriu lart. Zarja doli në rrugë dhe mori drejtimin e brigadës.

Në perëndim shkëlqente një drapër hëne. Në lindje vezullonte ylli i mëngjezit. Zarja ecte me hap të shpejtë, me shpirt të tronditur e të turbulluar, po me mendime të qarta si agimi i ditës së re. Nuk dëgjoi kur po e thërrisnin. Qëndroi vetëm kur i shoqi e zuri për krahu. Ai vuri re me habi se fytyra e saj nuk ishte më e çiltër si e fëmijës.

— Zare! — belbëzoi ai me ankth. Kish vrapuar aq shumë dhe mezi merrte frymë.

Ademi priste që ajo të derdhte lot. Sytë e saj tregonin se ajo ish aq e pikëlluar dhe e pafajshme, ndjente aq dhimbje në shpirt, sa atij i pikoi në zemër. Kurse buzët e shtrënguara fort shprehnin revoltë e vendosmëri që ai s'i kish vënë re ndonjëherë.

— Zare... S'kam çarë kokën shumë për këto punë, për ty, për babanë. Por tashti... babanë do ta bindim, do ta mundim...

Ndërkaq lindi dielli. Sytë e Zares shkëlqyen. Dikush i pa nga larg tek ecnin me hap të shpejtë e të zënë dorë për dorë. Në qendër të brigadës, një zë i gëzuar vajze çau ajrin:

-- Po vjen Zarja! Po na vjen Zarja!

*Nxjerrë nga gazeta DRITA Nr. 29, 1967.*

FLETË NGA DITARI I NJË AGRONOMI

Beqir Sokolin, ish-shefin e seksionit të bujqësisë në rreth, kisha gati një vit pa e parë. E takova pardje, kur kish zbritur nga kooperativa malore «Partizani» për një mbledhje. Në mbrëmje e gjeta duke shkruar diçka në një fletore të trashë.

— S'paske hequr dorë nga burokracia? — e ngacmova.

Ai qeshi.

— S'merrem me burokraci, — m'u përgjegj; — po përpiqem të bëhem shkrimtar. Që ditën që u ktheva në fshat nisa të mbaj ditar dhe, kohë më kohë, sa herë që jam i lirë, përpiqem t'i zgjeroj shënimet e shkurtëra. Ndofta, ndonjë ditë, mund edhe t'i botoj.

Me lejen e tij shfletova ditarin. Ai nuk pati ndonjë kundërshtim që unë të kopjoj dy data.

5 mars 1966

Kur arrita te Kroi i Buzit, kufi me fshatin tim, i zbrita mushkës, iu hodha nja dy herë ujë syve, e, meqë ishte herët, u ula mbi një gur dhe ndeza një cigare. Duke vështruar fshatin tim të ndarë në tri lagje, por shumë afër njera-tjetrës, si të zëna dorë për dore, se pse m'u duk për një çast sikur e shikoja për herë të parë.

Nga fshati kam më se njëzet e katër vjet që kam ikur. Dy vjet e ca kam qenë partizan, pas çlirimit — përgjegjës i bujqësisë, pastaj në shkollën e partisë dhe prapë përgjegjës i bujqësisë në rreth. Shkollën e mesme e kreu natën, bëra edhe dy vjet në Institutin e Lartë Bujqësor dhe pesë vjetët e fundit u caktova shef i seksionit të bujqësisë. Dje në mëngjes bëra dorëzimet



e fundit. Kështu që e kam harruar jetën e fshatit.

Te kroi i Buzit kujtova edhe një herë shtëpinë time në qytet, rehatinë... dhe ja tani: sytë më vanë menjëherë nga shtëpia e babait në fshat e pastaj pushtova me një vështrim tërë sinorin e vendlindjes. «Po babai, mendova, si do të më presë?!» Për nënën e dija dhe isha i sigurtë që do të gëzohej. Kur dërgova, verën që kaloi, fëmijët këtu në fshat, nëna nuk donte të m'i linte dhe, kur u kthyen, ajo më tregonte: «Si më iku nusja me fëmijët, më dukeshin këto shtëpi akull! Nuk më rrihej brenda! Gjeja ndonjë shenjë të fëmijëve, e merrja, e shtrëngoja në gjë dhe të gjitha i kam ruajtur në arkëz...».

Si mbarova cigaren, ndeza një të dytë, i hipa mushkës dhe mora përsëri rrugën. Ngado që çoja vështrimin më përshëndetnin të njohurit e mi të vjetër: arrat e Zdrëmçës, ku vija vjeshtëve i mblidhja, Bregu i Memës, ku i bija fyellit me barinjtë e tjerë, Gurët e Gjetë, Ujë të Zharrëzës...».

Kur arrita në shtëpi, dielli ish fshehur prapa malit. Rrugës, në të afruar dhe brenda në fshat, takova plot njerëz që më uruan:

— Erdhe? Mirë se na erdhe. E tregove edhe një herë se je biri i këtij vendi. Hajde, me faqe të bardhë.

Te muri i oborrit i zbrita mushkës, hapa trinën dhe hyra brenda. Babai po gdhendte një govatë në fund të oborrit. Ai nuk luajti nga vendi fare. Nëna doli te shkallët dhe iu kanos tim eti:

— Ngreu, o i zi, se na erdhi djali! — Pastaj u derdh nga unë: — Të keqen! Të keqen nëna! — Më vuri kokën në kraharor e s'më lëshonte.

— E di që babait i pëlqen një çikë të mbahet e të mburret, prandaj edhe më brente pak dyshimi si do të më priste, por që të ish kaq i ftohtë nuk e pandehja. Kur pata thirrur që ta dëgjcinin:

— E po mirë se na erdhe, or bir, — më thoshte — Mezi t'u bë mbarë; sikur i ke vetëm ti mbi shpatulla të gjitha punët e këtij pushteti!

Po ngroheshim pas zjarrit me nënën kur erdhi babai. Hoqi opingat te dera dhe më tha që atje:

— Erdhe?

— Erdha, — iu përgjegjja dhe u ngrita e përqafova.

— E muarëm lajmin që dy javë të shkuara — tha duke u ulur, po... — dhe nuk e mbaroi fjalën. Ai deshi të thoshte: «po nuk e besoja». Kurse unë u shtira sikur nuk e kuptova dhe vazhdova:

— Po u vonova gjersa bëra dorëzimet.

Biseda jonë ishte e shkurtër, e ftohtë nga ana e babait dhe si me zemërim.

— Ngreu, — e urdhëroi nënën, — bjerna nga një kupë raki e nga një meze.

Duke ngritur gotën, më vështroi ftohtë, me vetulla të mbledhura, midis të cilave dukeshin dy rrudha të thella, dhe më tha:

— Domethënë e vendose, erdhe?! — dhe me dorë bëri një lëvizje që donte të plotësonte atë që nuk e shprehu: — domethënë se mori fund.

— Po, po, — iu përgjegjja, duke cikur gotat.

Heshtja vazhdoi e rëndë. Nëna e vështronte babanë me inat gjersa shpërtheu:

— Mor, po ti ç'ke me djalin, që m'i rri kështu? Ai nuk është i vogël, Di se ç'bën! Dhe di më shumë se ti, në paç për të pyetur!

Ato që babai vlonte nga dëshira të m'i zbrakte mua, ja përplasi nënës; por, si i thonë fjalës, «foli plakës, të dëgjojë nusja»:

— Di, di, po nuk di! Se kur vija në pazar, më hidhin duart në qafë njerëzia dhe më thoshin: «Si je, baba i përgjegjësit? Si të kemi?». Unë mora vesh ç'kishte bërë ky dhe sado që s'më mbante vendi, nuk dola në pazar.

— Ai shef ka qenë edhe shef është!

— Po, po, — u tall babai. — Gjer dje komandonte një rreth të tërë: njëqind e njëzet e ca fshatra, kurse tani do të të komandojë ty, do të komandojë Nasipen e Nuriut, Ryvedinë e Dikes...

Pastaj u kthye nga unë, si pa gjë të keq, sikur të mos qeshë unë ai që më shau:

— Tjetër ç'kemi andej nga qyteti?

— S'ka gjë, baba. Letra e Hapur e Partisë na shkundi në shumë gjëra.

I tregova për zotimin që kisha marrë në mbledhjen e aparatit të komitetit ekzekutiv për të lënë zyrën e për të shkuar në vijën e parë të frontit të punës.

Më dëgjoi gjer në fund pa ngritur kryet të vështronte dhe, kur unë ngrita gotën ta çik me të, më pyeti:

— Domethënë ti iu përgjegje Letrës? S'ka gjë tjetër? — Tundi kryet si të mos besonte me një heshtje enigmatike.

— Ç'të ketë tjetër?!

Në këtë kohë na erdhën pas darke kryetari i kooperativës, sekretari i organizatës bazë të partisë, dhe dhjetë shokë të tjerë të kryesisë së kooperativës e anëtarë të thjeshtë. Më vonë erdhën edhe fqinjët. U mbush dhoma plot. Midis tyre qe edhe instruktori i komitetit të partisë për rrethin. Babai, tërë kohën që ndëjtën foli shumë pak, ata vetëm se i vështronte që të gjithë me sy hetonjës e në mënyrë të veçantë kur kuvendoja unë me ta. Menjëherë e kuptova se atë e brente diçka më e madhe se vendimi im për kthimin në fshat. Po çfarë? Nuk munda ta gjeja dot me mend.

Duke biseduar, instruktori i partisë bëri shaka me babanë duke më treguar mua:

— Shqiponjë e ke këtë djalë, shqiponjë. Një bërë, po ke ditur ç'ke bërë, shoku Jonuz!

— Shqiponjë e bëri Partia, — iu përgjegj babai, — se shqiponjë është vetë ajo.

Për të parën herë, gjatë gjithë mbrëmjes, mezi e pashë babanë që të buzëqeshte një herë.

Pastaj instruktori më pyeti mua:

— Sa fëmijë ke?

— Katër.

Ai iu kthye përsëri babait:

— Shoku Jonuz, paske një skuadër me nipër e mbesa!

Babai prapë vuri buzën në gaz.

Biseduam mbrëmë për tokat e reja që mund të hapim, për tarracat, për sektorët ku mund të mbjellim patatet... për gjithë problemet e kooperativës. Dhe kur ishte rasti, shokët thoshin: «Ja, tani kemi edhe shokun Beqir që do të na ndihmojë». Në tonin e sinqertë të tyre ndihej gëzim, shpresë... dhe babai më dukej sikur pyeste me vete: «T'ja thonë me gjithë zemër djalit këta këto fjalë, apo?!...»

Para se të ikte sot pas dite instruktori i komitetit të Partisë, pata këtë bisedë me të:

— E di ç'më tha babai yt?!

— Jo!

— Ai më pyeti: «Të më thuash drejt: ka bërë gjë djali im apo jo?!» Ko bërë, i thashë, ka bërë një gjë të madhe. U nxi në fytyrë dhe gati sa s'bërtiste: «Në ka bërë gjë, në nuk i ka punët mirë me Partinë, mos ma sillni këtu në fshat. Ta vuajë ku të dojë fajin që ka bërë. Se djalë e kam, të vetëm e kam, por...» Qesha me të madhe dhe e pushtova. Baba Jonuz, i thashë, djali yt ka bërë një gjë të madhe, por jo kundra Partisë po ashtu siç do Partia. Iu kthjellua fytyra menjëherë dhe ashtu siç e ka ai, më uroi prerë: «Udhë e mbarë».

Nëse tani e kuptova pse babai mbrëmë rrinte i vrerët dhe që atë nuk e mundonte vetëm sedra e tij që i pëlqen të duket, por edhe merakun mos unë erdha si fajtor e jo si vullnetar, nuk e kuptoj akoma se ç'e kishte shtyrë të mendonte në atë mënyrë. Po edhe këtë e mësova. Atij dikush i paskesh thënë:

— Nuk e luanin tët bir, jo, nga qyteti, po diku ka shkarë keq...

1 janar 1967

Dje kishim mbledhjen e asamblesë së kooperativës. Unë dhashë raportin në emër të kryesisë. Në jetën time rrallë kam provuar gëzim e krenari të tillë. E kam provuar gjatë luftës, kur zbrisnim në fshatrat e qytetet që çlironim dhe kur populli na delte i tëri, na puthte e na përqaftonte me shpirt të ndezur. Ky gëzim e kjo krenari m'u përtëri edhe dje. Ndofta dje unë thashë

me tërë shpirtin: «Sa mirë bëra që iu përgjigja Thirrjes së Partisë». Diku kam lexuar, nuk e mbaj mend, se «lumtëria më e madhe e njeriut është kur sheh se nxjerr një punë të mirë nga duart e tij». Por lumturinë e punës së mirë dje nuk e provova vetëm unë, atë e ndjen të gjithë kooperativistët. Ne dje bëmë llogaritë përfundimtare sa na takoi dita e punës dhe pamë përparimin që ka bërë kooperativa jonë.

Ndofta dje edhe babai do ta ketë shkukur fijen e fundit të mërisë ndaj meje që s'jam «kumandar i njëqind e njëzet fshatrave, por erdha të komandoj Nasiben, Hyrinë...» E them këtë sepse, ndërsa unë shkruaja për mbresat e ditës në ditarin tim, ai m'u lut me dhëmbshurinë dhe dashurinë e një babai krenar për djalin që e nderon, që ja duan të gjithë:

— Po mjaft, or bir, se u lodhe, u këpute! Lëri tani ato shkresa. Hajde të pimë nga një gotë, se kemi vit të ril!

U ula me të, ai në një kënd, unë në tjetrin përkundrej të duke, duke cikur gotat e duke u parë sy më sy, më dukej sikur më kujtonte ditët e kaluara dhe më kërkonte ndjesë me heshtjen e tij, që fliste më shumë se fjalët: «Më fal, o bir, se ti lodheshe, këputeshe dhe unë haja shpirtin duke të thënë: — Poo, le rahanë dhe kërkove belanë! Ti do të bësh njerëz ca e ca që s'kanë bërë prokopi kurrë! Por jo, me shokët e mirë që të dhanë dorën e që u dhe dorën, u bë jotja, jo imja...»

Si piu tri a katër gota, babai erdhi në qejf.

— Të ngremë një dolli, bir, — më tha, — për atë Barinë, sekretarin e organizatës bazë, për atë Gurin, Mustafanë, Bexhetin... se s'janë këtu e nuk na dëgjojnë, por që të janë bërë krahë dhe me ta... Se të them unë, or bir: vetëm zjarr të bëhesh, s'ke ç'bën.

— E di, baba, — iu përgjegja pa e shpurë fjalën gjer në fund, me një mënyrë si t'ja prisja shkurt: — ti e ke parë se unë më shumë vlerësoj ata. Dhe ai, duke tundur kryet:

— Po, po — më tha. Pastaj u krekos dhe vazhdoi: Ngreje dhe një herë ta pimë këtë për Partinë. Si thanë

ata delegacionet e huaja kur erdhën dhe panë tarracat tona: «Vetëm duke parë një tarracë e jo gjithë këto tarraca, njeriu do të mendonte se më i fundit këtu në Shqipëri është më heroi». Me partinë u bënë këto, or bir.

Nuk do t'i përfundoj shënimet e kësaj dite pa thënë diçka edhe për nënën. Ah, nënë, nënë! Gjithshka të mirë e të bukur që mund të kem në shpirt, shkëndijën e parë të asaj të mire dhe të bukur ma ke ndezur ti. Nënës, tek e shihte babanë ashtu si fajtor ndaj meje, nuk iu ndejt pa u shkrehur, duke e mbrojtur atë ashtu siç dinte ajo, për sjelljen e tij, për pritjen e ftohtë të natës së parë, kur u ktheva në fshat:

— Pi, pi aty, mos folë. Se e dimë që ti di më shumë dhe ke rënë nga të shtatë degat.

*Nxjerrë nga gazeta DRITA Nr. 23, 1967.*

### KUMBIMET E REJA TË PYJEVE

Dikush e shtyu derën e barangës, ajo kërciti, pastaj u hap ngadalë me një zhurmë të çjerrë, të zgjatur. Në prak u duk një fshatar plak.

Baranga ishte bosh. Vetëm një djalosh po rruhej i përkulur më dysh përpara pasqyrës. E kishte vënë keq pasqyrën mbi një tef dërrase, prandaj herëpashere e mbante me dorë.

Ai që po rruhej solli fytyrën gjithë shkumë nga dera dhe mbeti si i shastisur.

— Ç'ka ndodhë, tatë? Pse ktheve kështu menjëherë?

— U koritëm — mërmëriti plaku — Gjela iku.

— Si? Iku?

— Iku mbramë, Prend...

Thëllimi i ftohtë i mëngjezit u fut i gjithë brenda në barangë. Atij që po rruhej zu t'i dridhej mjekra.

— Me kë iku?

Zëri i djaloshit i ngjante zhurmës së mekur të detit pas baticës.

— Me një farë Col Marashi... Të duhet ta njofish.

Pasqyra luajti nga vendi dhe u thye përdhe. Djaloshi ktheu kokën prapa dhe përfshiu me një vështrim të shpejtë barangën bosh. Punëtorët tani po hanin mëngjezin në mensën e kantierit.

Prendi psherëtiu thellë, pastaj u ul dhe zgjodhi atë më të madhen nga copat e thyera të pasqyrës. Zu të rruhet prapë. Po mbi shkumën e sapunit tani zunë të zgjaten vijëza të holla gjaku, se i ipte briskut shpejt dhe se nuk e kishte mendjen aty. Nuk ndërroi asnjë fjalë

më me të jatin, madje harroi t'i thoshte të ulet. Ç'pat që iku? Ç'pat?

I hodhi një grusht ujë fytyrës, pastaj rrëmbeu sëpatën dhe doli me rrëmbim përjashta. Dera kërciti prapë pas tij me atë zhurmën e çjerrë dhe të mërzitshme. Ai zuri të ecte kuturo nëpër borë, pa u munduar të ndiqte ato shtigje e ngjeshura që humbisnin pyjeve.

Pylli po zgjohej si me mundim atë mëngjez dimri, i ngarkuar pjalm e borë. Diku larg po punonte një sëpatë dhe që poshtë nga mensa e kantierit vinin tingujt e një kënge të fortë:

Oh, Bajram Curri pla-a-a-ke  
Oh, i rrjedh mjekra gja-a-ake...

Ai vazhdonte përmes borës të futej në pyll me sëpatë në dorë dhe me një pamje të trullësuar. Në mendje të tij ushtonte vetëm një fjalë: Iku! Iku! Iku!

Oh, Bajram Curri i ri-e  
Oh, lufton për Shqypni-e...

Ç'këndojnë edhe këta në mëngjez!  
Prendi shpejtoi hapat. Punëtorët po ktheheshin nga mensa. Në mendjen e tij vetëm një gjë: e turpëruan!  
Solli ndërmend si qe fejuar me atë vajzë. Nuk i kish mbushur të trembëdhjetat atëhere. Po luante me fëmijët e lagjes, kur dikush e tërhoqi si mënjanë dhe i tha: «Mos luej ma me rrasa, Prend. Tata të ka fejue dje. Je burr tashma...».

Djali kish ndjerë frikë, frikë dhe shqetësim, ashtu siç ndjejmë kur përpara syve tanë ndehet tisi i errët i së panjohurës. Dhe ja kishte dhënë vajit. Kështu u fejua ai.

— Hej, ta marrë dreqi, ta marrë!

Prendi qëndroi në vendin e punës, hodhi pelicën në borë dhe rrëmbeu sëpatën. Pastaj i hodhi sytë nga rrënjët, gjer lart në majë të ahut që kishte përpara. Pylli zu të ushtojë nga krismat e sëpatës. Pas ç'do të



rëne druri i vjetër tundej lehtë, dhe nga kurora e tij shembej bora shtëllunga shtëllunga. Prendi godiste me furi, gati-gati me tërbim. Ai nuk ndjente dashuri për Gjelën, nuk kishte ndjerë asnjëherë, sepse nuk e njihte. Vetëm një herë e kishte parë rrëshqitas, se vajza ishte nga një fshat i largët. Kur mendonte për të, e kujtonte vetëm si një njeri që do t'i shtohet konakut. Por herë-herë mendonte se do ta donte pas martesës, se ajo mund të ishte e mirë dhe mund t'ja rrëmbente zemrën. Por në të vërtetë, sa më shumë kalonte koha, aq më shumë i mbante mëri të jatit që e fejoj të vogël. Kjo ishte një mëri e heshtur, një mëri që nuk guxonte të nxirrte kokën përpara hijes së rëndë të të parit të konakut.

Megjithatë, tani që iku Gjela me një tjetër, ai ndjente në shpirt sedrën e fyer, korinë, e gati-gati një hidhërim të tërbuar që një tjetër u përzie në fatin e jetës së tij. Po ç'pat ajo që iku? Ç'pat? A mos ishte ai Col Marashi më i mirë? Prendit nuk i kishte vajtur mendja kurrë ta maste veten me të tjerët. Ishte njeri i thjeshtë dhe e kishte zët mburrjen. Por tani, nën peshën e hidhërimit, zu t'i numrojë të mirat dhe të këqiat e veta dhe të atij tjetrit. E ai nuk peshonte më rëndë se Prendi, jo!

Vetëm se ai e njihte Gjelën, ishte nga një fshat aty afër. Ajo e kish dashur...

— Ah, daltë fare ky maraku, daltë fare!

Prendi i mëshonte sëpatës përherë e më shumë. Ashklat kërcenin përpjetë, pastaj zhyteshin në borë. Djalo-shi fshinte djersët dhe punonte me sëpatë sa i binin krahët. Forca e tij hahej me zemërimin që i vlonte përbrenda. Nga t'ja mbante tani? Ç'të bënte? Dikur këto punë zgjidheshin ndryshe...

Punëtorët po ngjisnin të përpjetën duke bërë zhurmë dhe duke qeshur me njëri-tjetrin.

— Hej! Prend-i, thirri njëri — po të ftofet çaji në mensë! Pse nuk shkon me hangër?

— Prendi e ka mirë me guzhinierin — zu të tallet një tjetër — i jep qumësht...

Prendi nuk u dha përgjigje. Ai i donte këta njerëz, e donte punën. Këtu e ndjente veten në vendin e vet.

I vinte keq që edhe pak do të zinin borërat e mëdha dhe do t'i duhej të zbriste poshtë në Sharra.

Prendi nuk ua mori për keq fjalët shokëve. Ç'faj kishin ata se ishte i mërzhitur ai?

Dhjetra sëpata të tjera nisën t'u bien drurëve. Pylli oshëtinte. Krismat sikur e shkundnin nga plogështia e mëngjezit. Ishin kumbime të forta ato që dëgjoheshin, kumbime të shëndosha, që sikur e përtërinin pyllin. Dhe kështu ishte në të vërtetë. Sëpata rrëzonte përdhe drurët e moçëm, të kalbur, të ngrënë nga koha dhe rrufetë, ndërsa linte në një anë të rinjtë, filizat.

— Shumë me yrysh e ke marrë, lum Prendi, dukesh si me ba dru për dasëm...

Një top bore fluturoi në erë dhe u thërrmua në këmbët e Prendit. Ai sollti kokën nga shokët.

— Rri, ti Gjergj!

Tjetri u afrua.

— Jam në qejf sot — tha.

— Në qejf qofsh gjithmonë!...

— Rashë n'godit me Lizën. Më ka çue fjalë...

— ...

— Me at prej Kashnjetit, more? Me at të fejuemen? Prendi heshtete.

— Bash si të kam pasë thanë.

Prendi vërviste sëpatën papushim.

Ai tjetri e zu nga krahu.

— Lene njiherë sëpatën, bre burr! Ç'ka ke sot kështu?

Prendi u kthye nga ai.

— Domethanë ti don me ja marrë gruen tjetrit?

— Ajo don me ardhë vetë me mue...

— Po a mendon për të fejuemin e saj? Për korinë që i len në shpinë?

Ai mezi i nxorri këto fjalë.

— Çfarë korie, more! Vajza nuk e njeft, as nuk e din. E kanë fejuje në djep. Si thue ti? Ta la cucën ta çojnë si delen te kasapi? Jo për të gjallë! S'asht punë korie këtu, asht punë jete. Kanë ndërrue kohnat... A nuk po ndien, a?

Prendi u ul mbi dru i kapitur.  
— Ndiej bukur mirë — tha — kanë ndërrue  
kohnat....

Ai u ngrit papritmas dhe mori andej nga baranga.  
I ati priste një fjalë nga ai.

— S'ka gja, tatë — i tha kur takoi plakun — ndoshta  
kështu duhet të ndodhte.

Plaku uli sytë, shkundi llullën, e shkeli me këmbë  
atë që hodhi përdhe dhe iku pa kthyer kokën.

*Nxjerrë nga gazeta «Drita» Nr. 5, 1968*

TËRË FSHATI E PËRCOLLI

— Në shkollë nuk do të shkosh, more vesh? Babait nuk i pëlqen, ndaj mos ngul këmbë, ndryshe sëpata na ndan në mes, — i bërtiti ai me inat.

Kujtimes iu shua menjëherë buzëqeshja. Ajo kish rendur fluturimthi te lëndina dhe që ulur pranë të fejuarit për t'i treguar me një frymë se, më në fund, i kish dalë bursa për të ndjekur shkollën në qytet. Kish kohë që e priste atë lajm. Sa ëndërra pat thurur për shkollën që do të ndiqte. Natën në shtrat apo ditën, vetëm ose mes shoqesh, gjatë punës a kur me vajzat e tjera u binte kryq e tërthor rrugëve të fshatit, ajo për shkollën e librat kish menduar. Në shkollë do të merrte shumë dituri. Pastaj do të kthehej në fshat një tjetër Kujtime, që do të punonte pa u lodhur për t'i mësuar fëmijët, që do të ishte e para në aksionet e që do të tërhiqte me vete vajza e nuse, duke i ndihmuar të shporrnin zakonet e vjetra e të çliroheshin nga bota e ngushtë e këtyre zakoneve. Ja, me një gëzim të tillë të madh kish vrapuar tek Astriti, kurse i fejuari, pa e hapur ajo mirë gojën, e kish pritur me këmbët e para.

«Babait nuk i pëlqen», — i kish thënë ai. Kjo ishte gënjeshtë. Ajo e njihte të vjehrrin. Atij, vërtet nuk para i pëlqente që vajzat e fshatit të shkonin në mbrëmjet e vallëzimit me djemtë, që ato të qeshnin e të bënin shaka pa u ndrojtur me ta; i vjehrrin, vërtet që zë-mëruar kur e kish marrë vesh se i biri paskësh një vit që bënte dashuri me Kujtimen; bile, kur do të shpallej fejesa kish thënë: «Bëni ç'të doni vetë. Se mos më pyeti mua im bir, kur u pleks me çupën e botës»; por më

vonë ai i kish buzëqeshur Kujtimes dhe nja dy herë e pat bekuar: «Më paç uratën, bijë». Pastaj, ai as të bijën s'e kish ndaluar të shkonte në aksion. Jo, Astriti gënjente.

Kujtimja e zuri të fejuarin përdore.

— Përse e ngatërron kot babanë? — e pyeti me të butë dhe vijoi: — Po qe se ai...

— Akoma ti?... Mori fund ajo punë, — e ndërpreu i fejuari akoma më ashpër. Ai u ngrit, si të donte t'i jepte fund atij muhabeti, dhe, duke parë diellin që po perëndonte, mori për nga fshati.

Kujtimja hapi sytë. E hutoi toni i ashpër i fjalëve të tij. Se ai përherë e kish pritur me buzëqeshje dhe i gëzohej me fjalët më të bukura. E ndoqi pas. Lëndinën e kaluan të heshtur. Kur dolën në udhëzën e fshatit, ajo e arriti:

— Të paktën, më thuaj përse më pengon të ndjek shkollën, — i foli përsëri me të butë.

Astriti shtrëngoi nòfullat dhe shfryu:

— Qenke tuafe e madhe! Le, po më vije edhe duke qeshur: «do të vete në shkollë»... Na, të plastë me gjithë shkollën tëndel!..

Këtë radhë Kujtimja shtangu në vend. Ajo nuk foli më. Bëri disa hapa pranë tij dhe u shkëput duke bëlbëzuar:

— Natën e mirë!

Tutje, nga malet, qielli i kuqërremtë u zbe. Ca shtëllunga resh, që gjer pak më parë flakëronin nga rrezet e diellit, u veshën me një ngjyrë gri të errët dhe filluan të nxihen. Udhëzën e fshatit po e mbulonte muzgu. Arat me misër, kodrat dhe malet përtej po i përpinte nata. Diçka e zezë si nata i kish rënë në fytyrë edhe Astritit.

— Asaj që i ndruhesha nuk i shpëtova dot, — mërmeriste.

Duart i kish mbledhur grusht. Këmbët i hiqte zvarrë. Sytë i hidhte si i çakërdisur majtas e djathtas. Por asgjë nuk shihte. Herëpashere kafshonte bishtin e cigares dhe pështynte përtokë duke nxjerrë cifla duhani. Dhe bashkë me ciflat lëshonte edhe fjalë të shkëputura:

— Ishim mirë e bukur!... Ç'dreq i ka hipur në kokë!...

Fliste dhe mendonte... E merrte me mend se si mund të mbaronte ajo punë, sikur Kujtimja të mos ndërronte mendje. Ajo qe e bukur. Me siguri ndonjë nga bukuroshët e qytetit do t'i vardisej e do t'ja merrte mendjen. Le të betohej e stërbetohej ajo se e donte shumë. Ehuuu, e dinte ai si sosnin të tilla gjëra. Pse thonë: larg syrit, larg zemrës... Pastaj, eh, pastaj... Kur ajo tani edhe s'po i bindej, por kur të kthehej nga qyteti më e ditur nga ai, as që do ta përfillte fare si burrë... Patjetër ajo do të kërkonte që ai të bënte ashtu siç kishin folur ato shoqet e organizatës së gruas, që kishin ardhur nga qyteti... Jo, or jo; gratë e qytetit le të bënin ç'të donin me burrat e tyre, edhe komunistët e rinia e fshatit le të flisnin; ai s'do të merrte mendtë e tyre... Po fajin e kish vetë, që nuk ja kish mbledhur fort qysh në fillim; të paktën t'ja kish shtrënguar rripat posa mori vesh se kish hedhur lutje për bursë dhe ata të kryesisë së kooperativës s'ja kishin përtuar të zbrisnin enkas në qytet për çështjen e shkollës së saj. Ç'është e vërteta, ai e kish menduar, por pati frikë. E dinte ai se, po ta merrte vesh fshati, do t'i vinin ndonjë fletërrufe e do ta bënin për pesë para. Andaj s'kish gjetur dot qetësi gjatë tërë verës... Po kur iku gushti, kaloi edhe java e parë e shtatorit dhe Kujtimen nuk e lajmëruan për t'u nisur, sikur u qetësua. Nisi edhe t'ja mbledhë pakëz. Kështu, ajo sikur po vihej në udhë. Kur ja, nga puna e shkollës nuk shpëtoi dot. Ej, ç'bela!

Astriti ecte duke zvarritur këmbët e duke pështyrë cifla duhani. Kohë më kohë qëndronte për të ndezur cigaret njërën pas tjetrës. Në ato çaste drita e zbetë e shkrepseve sikur ja shtonte egërsinë e fytyrës së tij të vrejtur, ndërsa hieja e trupit të tij stërzgjatej e deformuar anës udhës e tretej tek pemët e kaçubet pranë.

— Po ajo s'ka ikur akoma. Asaj i duhen edhe dy ditë që të niset, — foli me zë të lartë kur kish arritur afër shtëpive të para të fshatit.

Të nesërmen Kujtimja e pa te bredhi ku takoheshin

shpesh. Rendi drejt tij e qeshur. Ai bredh ruante kujtime të bukura për ta. Aty kish nisur vargu i gjatë i bisedave të tyre, tek ajo pemë i kishin hapur zemrën njëri-tjetrit, tek ai bredh takoheshin dhe thurrnin planet e jetës.

— Mirëmëngjes, Astrit, — i foli ajo duke e vështruar në fytyrë.

— I fejuari mblodhi buzët.

— Si i mërzitur më dukesh, — vijoi vajza me të qeshur dhe i vuri dorën në sup — Ç'ke?

— Ti e di fare mirë, — u përgjegj ai nëpër dhëmbë.

— Unë? — Akoma ti...

— Po, po, — e ndërpreu ai.

— S'po të kuptoj Astrit; ku e ke hallin që po më pengon?

— Po ti pse s'më dëgjon mua? A nuk jam unë burri yt? Pse, kështu do të formojmë familje ne, kur ti nuk bindesh?

Kujtimja vuri buzën në gaz dhe e ktheu si me shaka:

— Hajde luftëtar i emancipimit të vajzave dhe grave!..

Astriti u nxe dhe nisi të grindej:

— Nuk jemi në estradë këtu, more vesh? Dhe unë s'të lejoj që të tallesh zótrote, se s'je bërë akoma të më vesh në lojë.

— Ti nuk e di se ç'flet. Kohët e fundit nuk bën gjë tjetër veçse ankohesh nga unë.

Astriti zuri të thërrasë.

— Anko hem që ç'ke me të, se po bëhesh kokëfortë si mushka, tënden që tënden.

— E ç'farë të keqe ka në këtë mes, Astrit, që të zëmëroka kaq shumë, — u mundua përsëri Kujtimja ta zbuste inatin e të fejuarit. — Të gjithë po më përgëzojnë, sidomos shokët e shoqet e rinisë.

— Ashtu, eh! — shfryu ai; — qenkan gëzuar. Posi, posi... se mos humbasin gjë ata. E pse të mos gëzohen: teatër kanë për të parë. Veç ta dish ti dhe ata se kot gëzoheni. Apo ke qejf ta shtrosh këtë punë në mbledhje.

— Gjersa ti mos më shpjegosh përse nuk do, edhe mund ta shtroj. Se çështja e shkollës nuk është një gjë që ka të bëjë vetëm me ne të dy, por me krejt kooperativën, — s'e mbajti veten Kujtimja, ndërsa në cep të syve iu grumbulluan lotë.

Astriti dridhej i tëri dhe herëpashere përsëriste:  
— Dale, pa ke për të parë...

Mbledhja e organizatës së rinisë u bë atë mbrëmje. Kujtimja e heshtur dhe e kredhur në mendime, kish zënë vend mes shoqeve. Ajo ngriti kokën vetëm kur dëgjoi zërin e sekretarit që kumboi në sallën e shtëpisë së kulturës. Ai po fliste për Astritin, për mendimet e tij që s'përputheshin me kohën.

Astriti kafshonte buzën e poshtme. Sytë i kthente vjedhurazi nga shokët. Fjalët e sekretarit i binin si kamzhik. Padashur iu kujtua mbledhja e fshatit nja dy muaj më parë për komshiun e vet. Ky s'e kishte lejuar gruan të dilte në punë. E shoqja kishte shkuar vetë në arat e kooperativës. Atëhere ai e kish shembur në dru. Veçse ky dru i qe kthyer atij vetë në kurriz, pikërisht në atë mbledhje që fshati bëri kastile për të. Dhe kish qenë një «dru», që e kish dërmuar më shumë se çdo kopaçe e se çdo kamzhik. Balli i qe mbushur me djersë. Kafshonte përherë më shumë buzën e poshtme dhe përpiqej të kuptonte ato që po thoshin në mbledhje.

— Ai s'e len Kujtimen të vejë në shkollë se është xheloz, — po thosh Lulja. — Mbrëmë, kur po kthehesha nga fusha, e dëgjova vetë se si i shfrynte.

Astriti mbajti frymën. Diçka i theri në zemër. Ai u ngrit menjëherë, ndërsa sytë i shkëlqyen për një çast nga një qeshje djallëzore:

— E kini gabim, more shokë. Ç'janë ato që thoni. Unë ta pengoj atë? Bah!

— Mos gënje, — u hodh Lulja. — Unë të dëgjova mbrëmë.

— S'paske kuptuar gjë, moj shoqe. Se, plastë ai që i vjen mirë kur e fejuara i largohet për ca vite.

— Ashtu është, — se kush foli nga fundi.



— Apo shoqja Lule donte që unë të hidhja valle. Ndjaj le të matet para...

— Mos ndërro muhabet, — e ndërpreu sekretari. Ne e kuptojmë se të vjen keq. Edhe neve s'na vjen mirë të mos e kemi këtu gjatë kohës që do të shkojë në shkollë. Por na thuaj përse e pengon!

— Gjepura. Ja ku po e them përpara organizatës se unë s'kam ndonjë kundërshtim. Veç në mos dashtë vetë. Tjetër ç'doni nga unë? — U ul dhe nxorri shaminë të fshijë ballin e mbytur në djersë.

Kujtimes i ndriti fytyra. Në çastet e para nuk u zuri besë veshëve. Por ai kish folur shumë qartë. Ajo e kuptonte, se edhe ajo e ndjente dhëmbjen e thellë të largimit nga Astriti. Ndoshta ky do të qe edhe shkak që ai qe grindur ato ditë.

Pa dalë mirë nga salla Kujtimja e kapi Astritin nga krahu. E ndjente veten të mbushur me lumturi të tillë, që nuk e kish provuar asnjëherë. E, ngaqë nuk dinte si t'i shfaqte ndjenjat që i vërshonin në zemër, zuri të shtrëngojë krahun e të fejuarit. Por Astriti, i zbetë në fytyrë, vijoi udhën pa folur.

— Çelu, Astrit! Koha në shkollë do të kalojë shumë shpejt. Ne do të jemi përsëri bashkë, kurdoherë bashkë.

Astriti vijonte të heshtëte gjersa u larguan nga të tjerët.

— Qeshu Astrit! Ti përherë ke qenë i qeshur me mua, — vijonte e fejuara.

— Qenë të tjera kohë, — u përgjegj ai duke parë rrotull.

— S'po të kuptoj.

— Kujtove se do të më frikësoje me mbledhjen, eh? Mirë pra, je e lirë.

Kujtimja akoma s'po kuptonte, dhe nisi të bëlbëzonte:

— Po në mbledhje the se nuk do të më pengosh...

— Mirë pra, nuk të pengoj. Zgjidh: o burrin, o shkollën!

Vajza e shihte e turbulluar. Si ishte e mundur të fliste në atë mënyrë? Mos bënte shaka?

— Morën fund edhe shakatë tona. Ke akoma dy ditë të vendosësh: Dhe po qe se ngulmon për shkollën, qafën thefsh! — shfryu ai dhe humbi në errësirë.

Kujtimja zuri kokën me duar. Qëndroi si e ngrirë për disa çaste e dërmuar nga një peshë e rëndë, që i bëhej se po ja çante gjoksin. Por një valë e nxehtë iu përhap në trup, një valë që ja ndezi faqet, dhe ajo foli me zë të ulët plot neveri.

— Paska qënë mësallë me dy faqe...

Dy ditë më vonë Kujtimja kish mbështetur kryet tek ndenjësja e autobusit. Nga mendja nuk i hiqej fshati që e përcolli. Kishin dalë të gjithë të rinjtë e të rejat. Vetë sekretari i partisë e kish përqaftuar: «Mbaju trimëreshë, i kish thënë; ti je në rrugë të drejtë dhe ne jemi të bindur se do të na kthehesh kuadro e zonja». Para se të hypte në maqinë, ajo kish hedhur sytë edhe një herë nga fshati: Ndërtesat, shkolla, hidrocentrali pranë jazit, fushat e gjëra të kooperativës dhe nja dy traktorë që uturinin tutje, — iu dukën në ato çaste çuditërisht të bukura. Ishte e mallëngjyer dhe shtrëngonte shaminë në dorë për të mbajtur lotët, për të mos shtuar më tepër dhimbjen e prindërve që e shihnin të hutuar e të menduar. Nga autobusi kish parë për një çast dhe atë, larg tek kalonte për nga stallat. Iu duk si i kërrusur, i vogël. Kujtimja ndjeu t'i dridhej lehtë cepi i buzës. Por ktheu kryet menjëherë nga shokët e shoqet e rinisë. Pastaj maqina u nis dhe ajo e lodhur mbështeti kryet te ndenjësja dhe mbylli sytë nga die-lli që i binte në fytyrë.

— I ka dalë bursa, — dëgjoi të fliste dikë.

Kujtimja hapi sytë. Maqina çante përpara, po e shpinte drejt shkollës. Rrezet e diellit e ndiqnin nga pas me shkëlqimin dhe ngrohtësinë e tyre. Dhe pas dy ditëve e netëve plot shqetësime, ankth e vuajtje shpirtërore, ajo vuri buzën në gaz dhe shtrëngoi çantën me dokumentat e shkollës.

VAGONI 73

Vriste mendjen. «Ku e kam parë? Mos është Nuzi i ekipit të gjeologëve?»

— Hajde, gëzuar!... — tha ai që mund të ishte Nuzi i ekipit të gjeologëve.

— Gëzuar!

Birrën e pinin pa gota. Ishte shishja e tretë që zbraznin.

— Pimë edhe nga një... —tha ai që mund të ishte Nuzi.

— Edhe këtë mezi e mbarova...

Bufeja e stacionit zbrazej. «U hap dera...» Këtë fjalë dëgjoji Ramadani. (Ky është ai që pandehej se quhej Nuz. Dhe nuk është i ekipit të gjeologëve...).

— Unë do ta zbraz edhe një. Ti do? — tha ai që quhej Ramadan dhe jo Nuz.

— Jo, piva mjaft.

— Shoku garson, edhe një shishe... — dhe i tregoi një gisht...

— Mos të ikën treni?

— E arrij, — tha Ramadani.

Piu edhe shishen e katërt. Fshiu buzët. Pagoi shtatë birra. Dhe...

— Po ku punon tani? — e pyeti Ramadani.

— Aty ku isha. Në Cërrik.

Ramadani uli ballin dhe e shikoi me bebëzat ngjitur me qepallat e larta.

— Nuk je ti, Vasil?

— Cili Vasil?

Ramadani qeshi. Mbylli sytë dhe tundi kokën.

— S'ka gjë. Le ta zëmë se piva me Vasilin... Lam-tumirë shok...

— Udha e mbarë...

Ramadani u fut në vagonin 73. Të gjitha vendet ishin të zëna. Aty nga mesi i vagonit të gjatë dhe të ri, ishin dy vende bosh. Vajti dhe u ul. Përkundraill tij pa dy kurbatka. Njëra me një fëmijë në dorë. Tjetra e re. E bukur. Me sy të mëdhenj e të zez dhe me buzë të trasha. E shikonin të dyja. Ramadani kapi doçkën e fëmijës dhe i bëri «hehehe» duke qeshur. Edhe fëmija qeshi. Kurbatka e re e vështronte me sytë e mëdhenj, kurse kurbatka-nënë mbulonte kofshët e fëmijës që lëvizte dhe deshi të lozte me Ramadanin...

Kurbatkat flisnin në gjuhën e tyre. Ramadani lozte me fëmijën e kurbatkës. Kurbatkat shikonin nga ana e Shkumbinit tokën e gjelbëruar. Ramadani guduliste pëllëmbën e vogël të fëmijës së kurbatkës.

— Nga vini e ku shkoni? — e pyeti Ramadani,

— Vijmë nga Devolli, ku ishim me leje, dhe shkojmë në fermën e Fierit, ku punojmë.

— Motra jini?

— Po, — tha kurbatka nënë.

— Si e quajnë vajzën?

— Është djalë... e quajnë Ramadan...

— Ramadan?

— Po, Ramadan... — tha kurbatka nënë.

Ramadani qeshi. Dhe Ramadani i vogël qeshi.

— Pse, nuk ju pëlqen emri Ramadan? — pyeti kurbatka e re.

— Edhe më pëlqen, edhe s'më pëlqen.

Ramadani pa nga krahu i djathtë të tij një vajzë simpatike. E shikoi mirë. Ajo nuk i buzëqeshi.

— Biletën shok, — i tha ajo.

Ramadani, aty për aty, e humbi. U habit. Pastaj zuri të kërkonte nëpër xhepe... Dhe ndërsa Ramadani kërkonte nëpër xhepe, kurbatka e re që ishte në anë i dha punonjësës simpatike të vagonit dy bileta... Në kohën kur punonjësja simpatike shikonte dy biletat, erdh aty një tjetër udhëtar, dhe, pasi pyeti në ishte i

lirë vendi bosh, u unj. Ramadani u ngrit në këmbë...

— Mirë jam... — tha udhëtari i ri që u unj pranë tij. Ramadani as e pa dhe as e dëgjoi. (Kurbatkat e panë. Ishte një burrë i thyer në moshë, i veshur mirë. Kush e di, mund të ishte ndonjë arësimitar në pension...)

Ramadani, ashtu siç ish më këmbë, shkundi xhepet e pantallonave, kërkoi andej e kërkoi këndeje dhe... të tria (dy kurbatkat e punonjësja simpatike e vagonit) e shikonin herë në sy dhe herë në duart që i fuste në të gjitha xhepet dhe që i nxirrte bosh... Vetëm udhëtari i ri, që mund të ishte ndonjë arësimitar në pension, nuk merrte pjesë në këtë pritje... Ishte djalë i pashëm Ramadani. Këtë e vunë re që të tria. Me flokë të zez dhe të krehur si ata të filmave. Udhëtari i ri, që i ndenji pranë Ramadani, e nxori vetë biletën dhe i tha punonjësese simpatike:

— Isha aty... Ju e patë një herë...

Punonjësja simpatike e vagonit i buzëqeshi udhëtarit të ri që i tregoi biletën e çjerrë pakëz, por menjëherë e ndërroi shprehjen e fytyrës kur e ktheu nga Ramadani.

Ramadani i madh nuk qeshte më si Ramadani i vogël.

— Sa të kthehem, kërkoheni...

Punonjësja e vagonit 73 vazhdoi kontrollin e biletave. Kurbatkat shikonin në sy Ramadaniin e shqetësuar. Kurbatkat kuptojnë shumë gjëra. Dhe kontrollorja simpatike e vagonit 73, megjithëse është e re — e re edhe në këtë shërbim — kuptonte dhe ajo shumë gjëra.

— Mos nuk e ke prerë? — i tha kurbatka-nënë.

— Patjetër që e ke prerë — tha kurbatka e re duke e shikuar në sy Ramadaniin.

Ramadani i vogël qeshte.

Vagoni i madh oshëtinte nga tingujt e muzikës që përhapnin megafonët. Edhe ventilatorët e shumtë lëshonin shushurimën e tyre të freskët. Sa dëshëronte Ramadani që gjithë ventilatorët e vagonit t'i kishte pranë!

— Shok, e gjetët?

— Nuk e gjeta...

— Atëhere t'ju pres një biletë tjetër...

— Jo. Unë e preva një herë...

Udhëtari, që mund të ishte arësimitar në pension, shikon herë punonjësen e vagonit dhe herë Ramadanin.

— Pasi e kini prerë një herë, si thoni ju, ku e kini?

— Mund t'i ketë rënë gjëkund? As sa karta e cigares nuk është e shkreta... — tha kurbatka e re.

— Pse, të ka humbur bileta? — e pyeti udhëtari, që mund të ishte arësimitar në pension.

— I ka humbur... — përsëriti kurbatka e re.

— Si thoni? T'ju pres një biletë të re? — e pyeti kontrollorja e re dhe e shikoi në sy. Në sy e shikonin dhe kurbatkat që kuptonin shumë gjëra...

Dhe treni ecte, pa marrë parasysh se Ramadani ishte zënë ngushtë. Dhe këngët buçisnin nga megafonët e shumtë, pa marrë parasysh asgjë.

Ramadani nuk dëgjonte të paguante për të marrë biletë sipas rregullores së trenit.

— Ta paguajmë ne? — tha kurbatka-nënë.

— Pse ta paguani ju? E pagova një herë. Dhe ti... — i tha kontrollorës — pse ngul këmbë kot? Unë biletë tjetër nuk paguaj!...

Kontrollorja iku. Ramadani fshiu djersët.

— Mos nuk e ke prerë fare... — i tha udhëtari pranë.

Ramadani fshinte djersët.

— Muzikë e bukur... — tha kurbatka e re — Këndon bukur Vaçja...

— Mua më pëlqen më shumë Mentori, — tha kurbatka-nënë.

— Mua më pëlqen shumë kori karakteristik i pleqve të Korçës... — tha udhëtari, që mund të ishte arësimitar në pension...

Ramadani i madh nuk e dëgjoi pyetjen e udhëtarit që kishte pranë: «Po juve ç'ju pëlqen më shumë?» Ramadani i vogël zgjatte duart për të lojtur me Ramadanin e madh, po Ramadani i madh nxorri krehrin dhe u kreh. Dhe e shikoi me inat Ramadanin e vogël që zgjatte duart

për të lojtur. Këtë e vuri re kurbatka-nënë. Prandaj e qortoi Ramadanin e vogël duke i thënë: «Njeriu nuk ka nge të lozë gjithnjë...ka dhe halle...».

Erdhi aty përgjegjësi. Ramadanin e ftoi në zyrë. Për pak çaste. Ramadani nuk dëgjoi të ngrihej. Vendosi të shkonte. U ngrit. Dhe as që u hodhi ndonjë sy dy kurbatkave që e ndoqën me shikim gjersa humbi në fund të vagonit të gjatë që oshëtinte nga muzika...Dhe treri ecte.

— Simpatik — tha kurbatka e re.

— Mua nuk më pëlqen...— tha kurbatka-nënë.

(Këto i thanë në gjuhën e tyre. Udhëtari tjetër i shikonte ftohtë, sikur të mos ishin aty).

Aty për aty, udhëtari që mund të ishte arësimitar në pension, shikonte kurbatkën e re që ulej për të marrë bohçen me plaçka, nën ndënjësen e saj. E pa se si e hoqi shpejt e shpejt bluzën e zezë dhe të vjetër dhe se si shpejt e shpejt veshi një bluzë të re gjithë lule të bardha dhe të kuqe; e pa se si lidhi shpejt e shpejt përmbi ballë, duke lënë disa cullufe të vareshin, një shami të qëndisur; e pa të hiqte këpucët e lehta dhe të mbathte një palë këpucë të kuqe, me taka të holla dhe të gjata. Dhe pasi i bëri të gjitha këto në pak çaste, ajo hodhi shikimin përjashta në blerimin e tokës buzë Shkumbinit dhe koka i tundej sipas ritmit të muzikës që përhapnin megafonët e vagonit 73.

Pa dhe Ramadanin të vinte si atlet i mundur; e pa që u unj përkundruall saj; e pa që nxorri paketën...

«Si s'na kthen fare sytë...» — mendoi kurbatka e re dhe pastaj nisi të fliste me motrën e saj. Kot e kishin që flisnin në gjuhën e tyre se Ramadani nuk i dëgjonte fare. Atij i gjëmonte koka. Edhe vagoni gjëmonte. Nga muzika revolucionare...Po ja që muzika u ndërpre dhe u dëgjua zëri i spikerës së vagonit 73:

«Shokë dhe shoqe të vagonit 73. Midis jush kini një shok që nuk ka paguar biletën...Quhet Ramadan... E keqja është se ai gënjeu. Pastaj e pranoi që biletë nuk kishte prerë. Dhe e keqja më e madhe është se ai kishte shkuar me leje në shtëpi dhe leja ka dhjetë ditë

që i ka mbaruar... Na vjen keq, që ky shok mban akoma mbeturina të huaja për shoqërinë tonë... Ju ftojme, shokë udhëtarë, të shfaqni mendimin tuaj mbi qëndrimin e keq të këtij shoku plot të meta... Le ta ndihmojmë...»

Ky zë nuk u dëgjua vetëm në vagonin 73, po në të gjithë vagonat e trenit të ri. Dhe kudo u ndez biseda për Ramadanin. Grupe-grupe udhëtarët e çdo ndarjeje të vagonave të rinj kuvëndonin për fajin dhe jo gabimin e tij. Disa ngriheshin për të parë se cili ishte ky Ramadan «me sjellje dhe edukatë të huaj», që udhëtonte në vagonin e tyre, ku buçisnin këngët revolucionare dhe ku mendimi i çdo udhëtari u pre dhe u kthye në këtë faj dhe gabim të Ramadanit.

Treni kaloi tunelet para Peqinit, po asnjë nuk e vuri re, përveç kalamajve. Udhëtarët bisedonin për këtë Ramadan që udhëtonte pa biletë dhe që kish gënjyer; për këtë Ramadan që kishte shkuar në shtëpi me leje dhe që leja i kish kaluar dhjetë ditë.

Treni përsëkon kodra dhe lëndina të bukura buzë lumit Shkumbin. Pothuaj asnjë udhëtar nuk hedh sytë përjashta. Të gjithë duan të dinë se ç'është ky Ramadan.

Kurbatkat rrinë më serioze. E shikojnë ndryshe Ramadanin. Flasin në gjuhën e tyre:

Kurbatka-nënë: — Duket që është i fantaksur...

Kurbatka e re: — Po është simpatik...

Kurbatka-nënë: — Turp të ketë...

Kurbatka e re: — Mbase nuk ka pasur para...

Ramadani i vogël, ngre doçkat dhe kërkon të lozë. Ramadani i madh është i trubulluar. I demaskuar, i turpëruar. Të gjithë e shikojnë. Po ky as që e pa kurbatkën e re me bluzë të re dhe me shami të qëndisur... Udhëtari, që mund të ishte arësimitar në pension, thotë:

— Kësaj nuk i thonë fletërrufe, po fjalërrufe.

Kurbatkat e shikuan në sy. Ky mblodhi buzët dhe vazhdoi:

— Si është e mundur? — kthehet nga Ramadani

— Ti je i ri... Ke gabuar shumë...



Të dy kurbatkat pohonin duke tundur kokën.

Muzika ndërpritet. Dëgjohet zëri i spikerës:

«...Shoku Ramadan, ç'pret? Masa e të gjithë vagonave të fton këtu që të thuash fjalën tënde. Të bësh autokritikë...për gjestin e huaj për ne...Shumë letra na erdhën nga udhëtarët, sidomos nga ata të vagonit 73. Të gjithë e dënojnë sjelljen tënde dhe kërkojnë të vish këtu në mikrofon e të thuash fjalën tënde... Ata janë të mendimit që, për këtë gjest, ti duhet vetë t'ja thuash kolektivit tënd të punës kur të shkosh atje pa pasur nevojë që t'ua shkruajë Drejtoria e Hekurudhës...»

Ramadani i dëgjo i gjitha këto. Edhe kur nisi muzika, Ramadani po këto dëgjonte. I tingëllonin në vesh e në tru.

Kurbatka e re nuk e tund më kokën sipas ritmit të muzikës. Ramadani i vogël ka rënë në qetësi dhe duket sikur fle në prehrin e kurbatkës-nënë. Udhëtari, që mund të ishte arësimitar në pension, e shikon me vrejttje profilin e Ramadanit. Treni ecën me shpejtësi të madhe. Si mendimet e Ramadanit, që s'ka se ku ikën. Nga shikimet e udhëtarëve. Nga shikimet e kurbatkave. Nga shikimi i plakut që ka pranë. Mendon. Po mendimet e *tij ecin si treni. Gjëmojnë si treni. Zuri ballin me dorë. Mbylli sytë.*

Dëgjo i:

Kurbatka-nënë: — Shko Ramadan...

Kurbatka e re: — Ramadan, ke gabuar... Bëj autokritikë.

Kurbatka-nënë: — Shoku Ramadan, bëj autokritikë...

Udhëtari, që mund të ishte arësimitar në pension, shikon herë njëherë kurbatkë, herë tjetrën. Ramadanin nuk e shikon më.

— Shumë mirë i thoni... Shumë mirë i thoni... Ç'e kini, vëlla?

Kurbatkat nuk flasin. Shikojnë Ramadanin. Këtij i zien koka. Muzika e trubullon më shumë. Fjalët e kurbatkave, dhe sidomos të plakut pranë, e nxehin më shumë. «Si e bëra unë këtë? Pse gënjeva? Pse i prisha kot paratë në bufe? Sa piva unë? Po Vasili sa piu? Po

ai nuk ishte Vasili? Ku do të jetë tani Vasili? Sa i ngjante Vasilit!

Dëgjohet zëri i spikerës: — Shoku Ramadan... Ju duhet të thoni fjalën tuaj. Masa e gjërë e të gjithë vagonëve pret autokritikën tuaj. Kini bërë mirë apo kini bërë keq? Ejani në mikrofon... Ju presim...

Kurbaka-nënë: — Shoku Ramadan, shkoni flisni...

Kurbatka e re: Ç'pret Ramadan?

Ramadani i vogël fle i qetë, i nanuritur nga kënga e trenit. Ramadani i madh është i trubulluar. I poshtëruar.

Udhëtari plak, pranë tij: — Shko, mor bir... Ti je i ri... Bëre një gabim, pranoje ndershmerisht dhe këtë udhëtim mbaje mend për jetë... Udhëtim i madh për ty... po edhe për ne... Mësim i madh ky, për ty... po dhe për ne... (me vete) Ç'është masa e popullit? E fuqishme... Mësuesi më i madh... më i urtë..

Ramadani ngrihet. Dhe shkon drejt zyrës së përgjegjësit të vagonit 73, pa kthyer sytë as majtas dhe as djathtas. Sidomos në vagonin 73. Edhe koka e Ramadanit oshëtin. «Nuk ishte Vasili... Ku do të jetë tani Vasili? Pse i prisha paratë në bufe? Sa i ngjante Vasilit... Ku do të jetë tani? Po ai që më piu tri shishe, si quhet?...».

Të gjithë presin autokritikën e Ramadanit. Sidomos dy kurbatkat, që nisin e flasin në gjuhën e tyre...

— Kurbatka-nënë: — Turp të ketë, dhe është goxha djalë...

Kurbatka e re nuk i tha me fjalë mendimet e saj. Treni ecën me shpejtësi të madhe. Është treni ekspres, që nuk qëndron në shumë stacione të vogla.

Muzika e megafonëve ndalet. Dëgjohet zëri i spikerës:

— Shokë e shoqe udhëtarë... Dëgjoni autokritikën e udhëtarit Ramadan...

Të gjithë ngritën kokë e veshë. Edhe dy motrat kurbatka. Treni ecën me shpejtësi të madhe. Dëgjohet monotonia e uturimës së lokomotivës. Pastaj zëri i Ramadanit:

— Shokë e shoqe, që udhëtoni me këtë tren.. Unë kam gabuar...Gënjeva kontrolloren. Gënjeva veten... E them me gjithë mend...Tani më vjen turp. E përse? Se prisha paratë e biletës duke pirë birrë...

Kurbatka e re: — Ka pirë birrë...

Kurbatka-nënë: — Pusho...

Zëri i Ramadanit: Sa për kalimin e lejes, unë kam genë sëmurë... Dhe për këtë kam raport...

Kurbatka e re: — Ka qënë sëmurë.

Kurbatka-nënë: — Pusho të dëgjojmë...

Zëri i Ramadanit: — Unë i falënderoj gjithë udhëtarët e vagonit 73 për ndihmën që më dhanë... Falënderoj nga zemra punonjësit e këtij treni, sidomos kontrolloren e vagonit 73... Ju falem nderit...

Pas këtyre fjalëve buçiti muzika revolucionare.

Të gjithë e shikonin Ramadanin që kthehej nga zyra e përgjegjësit të trenit ekspres. Ai ecte me ngadalë. Nuk ktheu kokën fare. Shkoi te vendi i tij. U unj dhe ndezi një cigare.

Treni u ndal në Rogozhinë. Kurbatkat mblodhën plaçkat. Kurbataka-nënë diçka i tha Ramadanit, po ky nuk e dëgjoi. Kurbatka e re e pa në sy. Ky i buzëqeshi. Përkëdheli faqen e Ramadanit të vogël. Ato i thanë: «Mirë u pafshim...» Dhe ky, pa lëvizur nga vendi, u tha: «Ju falem nderit shumë...». Ato u larguan pa kthyer kokën. Ky i shikoi gjersa humbën midis turmës... Dëgjoi fishkëllimën e trenit. Dëgjoi uturimën e lokomotivës. Pa të kalonte andej kontrollorja e re dhe simpatike. E pa që i buzëqeshi. Edhe ky i buzëqeshi.

Kjo buzëqeshje dhe tingujt e muzikës revolucionare, që bënin të oshëtinte vagoni 73, sikur po e shkarkonin nga diçka e rëndë që i vriste ndërgjegjen...

Pastaj nisi të shikonte përjashta fushat e gjelbëruara.

*Nxjerrë nga gazeta DRITA Nr. 33, 1967*

## Vedat Kokona

### TYRBJA

Vinin aty, në vendin e shenjtë, kush e di prej sa vjetësh. Ndofta edhe prej shekujsh.

Pleqtë e fshatit nuk e mbanin mend se kur ishte ndërtuar tyrbja, ajo përmendore hijerëndë, që ngrihej mbi varrin e një shënjtori.

Që në vogëlinë e tyre ata kishin dëgjuar nga prindërit, — dhe këta nga prindërit e tyre, — se atje ishte varrosur një evlia, një njeri i shenjtë, i dashur i Perëndisë dhe, sa herë që nëna ose babai kishin një hall, shkonin tek ai vend dhe faleshin, faleshin me gjithë shpirt që të lehtësonin zemrën e brengosur. I luteshin Perëndisë me fjalët më të zjarrta, i truheshin se do ta njihnin për gjithë jetën si krijuesin e plotpushtetshëm. Fjalët e lutjes shqiptoheshin me afsh, me një dëshirë që buronte nga thellësitë e qënjes, symbyllur e buzëdredhur.

Vinin aty pleq rreshkataqë e mjekërthinjur, që vuanin nga cërma dhe luteshin që Zoti t'u kthente fuqinë e pabesë; plaka të gërmuqta, hundëkërrusura e mjekërdala, dhëmbërëna e lëkurëfishkura, me atë kokë të lidhur me napë të bardhë që tundej pa pushim si gjethe plepi dhe dukej sikur pyeste se ç'qëllim kishte pasur jeta e tyre e shkuar në robëri; nuse të reja trupmënjolla e belholla, që donin të shijonin frytin e një martese gjer atëhere shterpë; fëmijë të vegjël, të shoqëruar nga nënat e tyre, që kishin marrë sysh, apo që s'përkëmbeshin dot. Të gjithë vinin të shtyrë nga halli dhe jo nga malli.

Tyrbja qëndronte aty, e rëndë dhe e heshtur në madhëstinië e saj të pacenuar, në mes të fushës. Rreth e

rrotull shtrihej toka deltinore, herë, e rreshkur dhe e plasaritur nga dielli i korrikut, herë baltake dhe llapërcinë nga shirat e vjeshës, ku shllapuritnin fshatarët këmëzbathur dhe ku luturiseshin fëmijët zhelanë.

Varri në mes të tyrbes, mbuluar nga hithrat dhe nga shpendrat, u ndillte frikë edhe respekt atyre që shkonin aty pranë. Fëmijët nuk guxonin të luanin atje, se kishin dëgjuar nga prindërit që vendi i shenjtë s'duhej shkelur, se të vriste Zoti. Ata rriteshin dhe ndjenja e frikës dhe e respektit i shoqëronte gjersa vdisnin.

Kështu kishin kaluar vite. Kështu kishin kaluar shekuj. Njerëzit lindnin, jetonin, vdisnin; jeta kalonte me gëzimet dhe hidhërimet e saj, por tyrbja qëndronte atje, gjithmonë e rëndë dhe e heshtur, gjithmonë më shumë e mbuluar nga hithrat dhe nga shpendrat. Thuhej se kjo tyrbe kishte mbetur që nga koha e Turqisë.

Pa dyshim që një evlia i madh ishte varrosur atje. Themelimi i saj humbiste në mjegullën e kohës, si gazi i fshatarëve buzëplasur, por lavdia e saj dukej e pavidrë, e shkëlqyer si rrezja e diellit që i binte përsipër.

Kështu kalonte koha, kështu iknin e vinin vitet dhe tyrbja qëndronte po aty, e patundur dhe e nemitur.

Fusha rreth saj, pak e gërvishtur nga parmenda e vjetër, me plug të çallatuar, nuk i jepte fshatarit bukën e gojës. Fshatari, që ishte në hall të madh, vinte e falej te tyrbja, por tyrbja rrinte gojëkuçur, e padëpërtueshme, si sfinksi.

Por erdhi një ditë...

Erdhi një ditë kur fshatarët u bënë traktoristë dhe çanë tokat me traktorë dhe jo me plug të çallatuar. Fusha rreth tyrbes, nga një baltovinë siç kishte qënë prej shekujsh, u kthye në një tokë buke. Në mes të grurit kërcelartë zbardhën boçet e pambukut që vinin e i vilnin fshataret duararta. Kodrinat e zhveshura, të gërryera nga përrenjtë e rrëmbyer, që rrethonin fushën, zunë të ndërronin fytyrë: qinda vajza dhe djem të rinj, të armatosur me kazma dhe lopata, iu ngjitën kodrave përperjetë dhe, me këngë në gojë, i bënë tarraca dhe vreshta. Nga ajo baltë e ngjeshur dhe e fortë si çitë

mento; ku mezi futej kazma e mprehtë, mbinin tani bistakët e rrushit kokërrzi e kokërrbardhë, frut i kooperative s'ë re.

Toka punonte, kodrat punonin, të gjithë punonin.

Por tyrbja rrinte gjithmonë e patundur, hijerëndë dhe madhështore, e heshtur dhe enigmatike në mes të asaj jete që gumëzhinte rreth e përçark. Dukej sikur u thoshte njerëzve: «Ju çani toka, shkulni shkëmbinj, i ktheni kodrinat në vreshta, lumin në dritë, por mua s'më luani dot nga vendi, se unë jam Tyrbja, Tyrbja e shenjtë, që ka qënë, është dhe do të jetë për ngahera!»

Edhe vërtet pleqve as që mund t'u shkonte ndonjëherë ndër mend se ajo tyrbe shekullore, hijerëndë e madhështore, mund të luhej nga vendi. Ata s'guxonin ta krahasonin me malet, se rinia e sotme edhe malet kishte filluar t'i luante nga vendi! Malet mund t'i luainin, por Tyrben jo! Jo vetëm që ajo s'mund të luhej nga vendi, por ishte mëkat edhe ta mendoje një gjë të tillë. E ku të faleshin ata pastaj?

Po ja, djemuria, tani mendonte ndryshe. Ajo le që s'vinte të falej atje, por as që donte t'ja dinte për këtë tyrbe të lashtë, që mbulohej gjithmonë më shumë nga hithrat dhe shpendrat.

Dhe një ditë...

Bubu! ç'dite ja kishin arritur pleqtë e varfër, besnikë të Tyrbes! Një ditë, djemuria e fshatit, e rritur me zakone e ideale të tjera, u ngrit e tha në një mbledhje:

— Do ta prishim tyrben! Do t'i vemë kazmën! Ajo është një lungë plot me qelb në trupin e shëndoshë të Atdheut! T'i biem me thikë edhe ta çajmë!

Pleqtë u drodhën kur dëgjuan këto fjalë. Si ishte e mundur që goja e njeriut të shqiptonte një mallëkim të tillë? Dhe kundër kujt? Kundër asaj tyrbeje, së cilës i ishin falur kaq breza! Është e vërtetë se ajo tyrbe nuk kishte plotësuar asnjë nga dëshirat e tyre; ajo s'u kishte dërguar ujë kur toka digjej e etur për një vesë shiu; ajo s'i kishte shëruar nga sëmundjet e rënda që u rëmbenin të dashurit pa mëshirë; ajo s'u kishte kthyer shëndetin e fëmijëve rakitikë që qanin natën, jo sepse kishin

marrë sysh, por sepse kishin rënë të flinin të uritur, me atë çikë gjizë që kishin ngrënë, ajo s'i kishte shëruar nënat e reja që fërgëllonin nga ethet e lehonisë dhe as u kishte drejtuar trupin pleqve kurrizdalë që sa vinin e shtrëmbëroheshin më tepër, aq sa, kur ecnin për të shkuar te tyrbja, dukeshin sikur kërkonin të hynin një orë e më parë në atë baltë nga e cila kishin frikë. Ashtu të kërrusur e këmbëzbathur dukeshin si pikëpyetje mbi atë baltë që s'i kishte ushqyer.

Të gjitha këto ishin të vërteta, por tyrbja si mund të prishej?

— Do ta prishim tyrben! — kishin thënë djemuria e fshatit.

Edhe vërtet një ditë ata rrëmbyen kazmat dhe lopatat dhe filluan nga puna...

Kishte plaka që dridheshin për djemtë: si kishin guxim t'i vinin kazmën tyrbes, atij vendi të shenjtë? Pleqtë hungronin të pezmatuar. Por jo të gjithë: kishte nga ata që kishin filluar të talleshin me besimet dhe zakonet e kota, ishin bërë me rininë. Punonin sa mundnin me ta bashkë, këndonin e hidhnin valle dhe vetëm për një gjë u qante e shkreta zemër ku të gjenin një ilaç për t'u bërë nja gjysmë shekulli më të rinj.

Ja, pra, këta pleq u jepnin zemër të rinjve, edhe të rinjtë i vunë kazmën tyrbes. Pleqtë besimtarë prisnin që mallëkimi i Perëndisë t'i gjuante firaunët me kokrrën e rrufesë, por rrufeja s'kishte niet t'i vriste djemtë: sipër tyrbes ndehet qielli i kulluar dhe dielli qeshte apo s'qeshte bashkë me rininë majë tyrbes së legëndisur!

Kazmat shkullnin nga vendi gurët e rëndë dhe duart e shkathëta të rinisë i vërvitnin tej.

Si e shkatërroi tyrben, rinia iu përvesh varrit vetë. Lopatat tehmprëhta e faqendritura i qëruan shpejt e shpejt hithrat e shpendrat shekullorë dhe pastaj balta e varrit, e punuar nga ato duar të forta, zuri të ulej, të ulej, gjersa u rrafshua me sipërfaqen e tokës dhe pastaj u thellua, u thellua...

Pleqtë besimtarë prisnin zemërdredhur rrufenë që do të binte ndofta edhe mbi kokën e tyre. Por dielli

vazhdonte të qeshte si edhe më parë në qiellin e kulluar.

Dhe pastaj...

Dhe pastaj ndodhi ajo që askush nuk e priste. Lopatat, që nxirrnin baltën e fundit të varrit, nxorrën edhe një kockë të madhe, pastaj edhe në tjetër. Ishte hapur një varr i madh, ndryshe nga të tjerët, i gjatë edhe i gjërë, jo si varr njeriu i zakonshëm, kockat e mëdha dëshmonin qartë se ky s'ishte varr si gjithë varret e tjerë. Kufoma që po zbulohet, tregonte sheshit se këtu kishe të bëje me diçka të përbindshme. Kufoma e tyrbes i shëmbëllente asaj të kalit. Dhe dyshimi u zhduk kur lopatat e fundit nxorën nga balta një kafkë kali!

E vërteta ndrinte si rrezja e diellit dhe ata që ishin mbledhur rreth e qark varrit vështronin të habitur.

Të rinjtë ja plasën gazit:

— Shife, nanë, evlianë që ishte varrosë në tyrbe!  
Këtij kali i jeni falë gjithë jetën!

Pleqtë besimtarë vështronin dhe s'u zinin besë syve: në atë tyrbe, ku ishin falur e lutur kaq herë, ishte varrosur një kalë! A ishte e mundur? Po t'u thoshin një gjë të tillë, ata s'do ta besonin kurrë, por ja që të vërtetën e shihnin tani me sytë e tyre.

Kockat e kalit shkëlqenin në diell dhe dielli majë qiellit qeshte me ta.

*Nxjerrë nga gazeta DRITA Nr. 39, 1967*



## Ferhat Cakaj

### UNË, VAJZA FJALË PAKËT

Nga fejesa ime mbaj mend një misër të pjekur dhe një petull; jo më shumë. Atë ditë vjeshte unë luajta mbyllasyza me shoqet e mia të shkollës fillore deri vonë në darkë. Kur u ktheva e gjeta nënën tek bënte petulla, kurse vëllanë e vogël tek piqte misra qumështorë. Kuzhina me tavan të ulët e me trarë të nxirë nga tymi mbante erëra të mira.

— Ku humbe, moj korbë?! — më tha nëna, sa më pa.

— Dritë, na një misër të pjekur, se po ta bëjmë dasmën... — më tha vëllai.

Unë s'kuptova gjë. E shtyta tutje vëllanë, mora misrin, i rrëmbeva një petull nënës nga sahani dhe dola me një frymë në oborr.

— U bëfsh korbë, moj! A s'e shikon kë kemi për darkë? — më thirri nëna.

Por mua aso kohe s'më interesonte asgjë më shumë se misri i pjekur dhe petulla.

Të nesërmen gjithë fëmijët e fshatit nisën të tallen me mua:

«Ee, ee! erdhi nusja, erdhi nusja!»

Unë e dija se kjo ishte një punë e keqe dhe më lëndohej zemra sa s'bëhej; por përse, s'merrja vesh gjë. Unë e ndjeja se ish diçka e turpshme, diçka e shëmtuar që më ndante nga fëmijët e tjerë, më hiqte të drejtën e lojrave dhe më veçonte. Kaq.

\* \* \*

Kur mbarova tetëvjeçaren, më thirrën në byronë e rinisë.

— Shoqe Dritë, më tha sekretari, po ta themi copë. Të kemi thirrur për punën e fejesës...

— Ç'hyn këtu fejesa ime? — pyeta unë.

Sekretarit i erdhi keq nga fjalët e mia. U skuq dhe u ngrit i shqetësuar. Mori një libër të vogël, e shfletoi dhe ma vuri përpara.

— Shiko ç'shkruan për ty shoku Enver, — më tha. Të rrënqethura më kaluan nëpër shtat. Vite të tëra isha ndrydhur në botën time dhe prisja me ankth si vdekjen, martesën me të... Të fejuarin ma kishin përshkruar mirë. Ai ishte një fshatar nja tridhjetëetëvjeçar, pa asnjëri, por shtëpinë e kish plot me gjithë të mirat. Jetonte qyqe vetëm. Kur e mendoja veten në shtëpinë e tij të vetëmuar në pyll më zinin të dridhurat dhe prisja martesën si pret një i sëmurë vdekjen. Unë mendoja se caku i jetës do ish deri te praku i asaj dere. Aty jeta s'do merrte më frymë. Me askënd s'flitja për këtë punë dhe askush nuk ma kish qarë hallin. Sa net pa gjumë, sa lot të heshtur, sa ëndërra të trishtuara kalova, aq të mira u bëfshin! Bota do të çuditej po t'i thosha se gëzimet e mia u tërhoqën zvarë-zvarë që atë darkë me misrin e pjekur dhe me petullën. Unë u bëra serioze, e menduar dhe fjalëpakët. Ashtu jam edhe sot. Lodrat e fëmijërisë i mbaj mend para asaj darke. Më vonë s'pata më fëmijëri. E ç'fëmijëri e zezë është ajo, kur nëna çdo ditë të zë në gojë «pajën» dhe «burrin», kur shoqet s'të lenë rehat me romuzet e pambaruara, kurse gratë e fshatit të vështrojnë me dhimbje, ndërsa pleqtë nisin bisedën mbi atë... të fejuarin tim. Jo, jo, mbi supet e mia qëndronin të gjithë, veç fëmijërisë...

Edhe shkollën e shkretët unë ja di për nder sekretarit të Partisë, se përndryshe do ta kisha qarë me kohë si fëmijërinë time. Dhe ja, të njëjtat të rrënqethura më kaluan përsëri, kur i pari njeri, pas kaq vjetësh, po trokiste në dyert e shpirtit tim, pikërisht aty, në plagën time të vjetër e të fshehtë, në fejesën time. Dhe ky njeri ishte sekretari i rinisë.

E mora librin e shokut Enver dhe lexova disa radhë të nënvizuara bukur me laps të kuq. Aty kishte me të

vërtetë diçka për mua, tamam për mua. Sikur t'i dinte ai mendimet dhe ç'fshihja në zemër unë.

— E, si thua? — më pyeti përsëri sekretari.

E shikova në dritën e syrit. E ç'ti thosha? Unë isha bërë gjashtëmbëdhjetë vjeçe, isha në prak të martesës, «vazjë devojkë», — si më quante nëna mua çupën serioze, të menduar e fjalëpakët.

— Ç'të them? — e pyeta edhe unë atë...

— E do apo jo plakushin?

«Plakushin» unë s'e kisha parë kurrë. Ja ç'më doli! Unë ula kokën; isha gati t'ja plasja vajit e të shfreja gjithë atë mllef, mbledhur prej vitesh. Por e përmbajta veten:

«E ç'ka ndër mend të bëjë ky? — thashë me vete».

— Dritë! Tregomë të vërtetën, për këtë na ka ngarkuar partia. Tani s'është vonë...

— Partia...! përsërita unë si një foshnje dhe rashë në të thella. «E pse mos t'ja them? Ky është djalë i mirë, s'nxjerr fjalë edhe ta vrasësh...» mendova.

— Nuk e dua, shoku Musto, nuk e dua. Unë atë njeri nuk e njoh fare. Ditëzeza unë! — dhe lotët më vërshuan të papërmbajtur.

— Mos qaj, budallaçkë, — më foli Musta. — Ende s'ke marrë vesh ti si po luftojmë ne sot?... Domethënë nuk e do?

— Jo, jo! Të shkojë në djall me gjithë pajën dhe pasurinë...

Në kokë kisha një lëmsh mendimesh që s'dija t'ua gjeja fillin.

Dhe që nga ajo ditë nisi sherri. E çfarë sherri se! Këtu qortime e fjalë për paratë që kish ngrënë im atë, atje mbledhje rinie, këtej kanuni i dreqit, kërcënime, andej fletërrufeja e mbledhje fronti. U desh një «jo» nga goja ime dhe nga ajo buçiti fshati, buçiti krejt përroi i fshatit tim malor me uturimën si në kohën e luftës. Këtë buçimë e dëgjuan të gjithë sa qenë e nuk qenë për rreth tij, miqtë, farë e fisi dhe, me siguri, edhe i fejuari im në shtëpinë e vetëmuar në mes të pyllit, me të gjitha të mirat, por qyqe e fillikat.

Si në ëndërr, një ditë Musta më tha:

— Dritë, u prish përfundimisht fejesa. Isha në zborr me atë «qametin». Bënë një mbledhje të përbashkët zboristët tanë me ata të kooperativës së atij. Na kryesoi komisar i brigadës. «Dhëndërrushi» hoqi dorë dhe bëri be e rrufe. Aty morëm vesh se do të martohet me një grua të ve që ka dy jetimë. Edhe ai është i ve, por pa fëmijë. Kishte nja dyzet «pranvera» në pasha-portë. Kishte...

Por unë nuk e dëgjoja më Muston. Isha mpirë në trup e në tru. Musta ish bërë për mua gjithë ç'kam parë më të mirë te njeriu deri më sot. Iu hodha në qafë si e marrë dhe e putha. E putha, ju them, mos u çuditni! E putha unë fjalëpakëta, seriozja dhe e menduara. Mirë që s'na pa kush, se do të më shqyente im atë, ndonëse tani unë s'pyesja më fare. Isha bërë zok me fletë; gjithë bota ish imja.

Për t'im atë unë s'ju fola gjatë. Puna e tij lidhur me mua është një histori më vete.

Ai u egërsua dhe u mbyll fort gjatë gjithë kësaj kohe. U mplak njëherësh, u mplak sa s'thuhet: «Mirë bëri, po jo e para në fshat...», s'pushonte së thëni me zëmërim kur bisedonte e grindej me nënën. Shpesh nuk vinte fare në shtëpi, flinte në luadhe me disa bagëti. E kish humbur pusullën. Dhe mua më dhimbsej... Ashtu si ai bënin të gjithë më parë... S'kish faj. Cili është ai që nuk e do dritën e syve të vet? Kështu edhe prindi.

Para disa muajsh të gjitha vajzat e fshatit tonë dolën vullnetare. Formuam një brigadë më vete. Im atë s'foli asgjë. Çdo mbrëmje vinte në shtëpi. Heshte. Pinte duhan dhe heshte. Natën e fundit më tha:

— Nesër unë do të shkoj herët në kooperativë. Po t'i them dy fjalë. Mendoju dhe shikoje mir punën tënde, moj bijë. Kjo rrugë që po hapni ju, për ne është e panjohur...

Unë i kuptova mirëfilli fjalët e tij, që ishin si të shtëna pushke në heshtjen e një nate. Desha t'i përgjigjesha në çast. Por e di që atij s'i pëlqejnë fjalët. Prandaj nuk e dëshpërova. Heshta dhe ula kokën. Kjo

është shenjë e një nderimi dhe bindjeje të plotë këtej nga ne. Po unë babanë e kam dashur dhe nderuar gjithnjë, edhe në fatkeqësinë time të derivonët...

Të nesërmen me të vërtetë nuk e takova dot. Ai kish ikur në arat e kooperativës, para se të zgjohej fshati. Nuk munda të zbuloj pse e bëri këtë. Por, pasi u ktheva nga hekurudha, e mora vesh. Atë e mundonte shumë prishja e fejesës, por më shumë fejesa ime e re. Ish shqetësuar fort për këtë... «Si do të bëhet tani? Kush do ta marrë atë, cilin do të zgjedhë vajza ime?» Ja, këso pyetjesh me siguri i silleshin vërdallë në kokë, e cingëritnin trurin e tij dhe s'e linin të qetë.

Ditën që u kthyem nga hekurudha, u ndalëm në mes të fshatit. Ishim dy maqina vajzash, jo pak. Fshati i tërë na shikonte i habitur. Në vend të çitjaneve kishim tuta, bluza e disa edhe fustane e sandalle. Në qafë shamitë — emblemë të aksionit. S'kishin ç'na thoshin. Ishim afërsisht njësoj të gjitha. Im atë rrinte në ballë të popullit i gëzuar këtë radhë. Gëzimin ja shihja në lëvizjen e shpeshtë të qerpikëve. Ç'e gëzonte? Shëndeti im, apo shenjat «Sulmuese», që mbaja në gjoks? U lëshova me vrap, vajta e përqafova dhe e putha aty ballë popullit...

— Bijë e babait... bijë e babait... — ai s'dinte ç'të më thosh, si të shprehej.

Kurse Musta qeshte dhe na shikonte ne të dyve...

*Nxjerrë nga gazeta DRITA, Nr. 43, 1967.*

## NE FUSHË, NDANË LUMIT

Edhe ato tri-katër shtëpi mësuan vetëm këtë lajm: vëllai i Axhemit me dy kushërirat e tij të para u nisën në një karvan të vogël, me tri mushka dhe një kalë, të shtunën nga mezi i ditës, për tek nusja. Thanë se njerëzit e nuses e sollën vajzën gjer poshtë tek Ura e vjetër dhe aty, si u përshëndoshën me njerëzit e burrit, ndoqën rrugën e zënë vetëm dy prej tyre. Edhe ato gra.

Pas pak, ajo trumbë e vogël krushqish, pa zhurmë e bujë, ndjenë t'i shurdhonin tri pushkë dhe dy bomba mu aty afër. Atë çast vëllai i Axhemit bëri ca porosi dhe çau si kaçak në drejtim të fshatit, duke rrahur pëllëmbët i përkulur mbi gjunjët e shëndoshë.

Kur hynë në fshat, rrugët ishin boshatisur. Kopetë e bagëtive kishin ardhur më shpejt. Nusja dhe njerëzit e saj ndjenë diçka. Megjithatë ata ecnin të menduar, ashtu si më parë. Ata nuk pyetën njeri. U bëri përshtypje tërë ai fshat i madh, rrugët e gjëra dhe shtëpitë dykatëshe e të zbardhura. Aty këtu ndihej gjuha e ndo një këmbore, që cungonte atë fashitje, e cila porsa ishte nderë.

Kur kali ktheu nga e majta, nusja mënjanoi pak kindin e varur të shamisë për të parë me sytë e saj atë fshat. Tek një derë u duk një grua dhe pas pak dy-tre fëmijë, që kapeshin pas fustanit të saj dhe shihnin me habi ato gra që ecnin hipur mbi kafshë.

Përballë, nga lindja, shtëllunga të mëdha resh ngjiteshin që prapa malit.

— Do të kemi shi! — pëshpëriti një zë.

— Vajti kohë që e presim. Të kish rënë më parë.

Ata kthyen lart dhe, kur shkarkuan në oborrin e shtëpisë, të gjithë përtypnin mendimin se si do të kalonte ajo natë.

Ish një shtëpi e vogël ajo, tej në anë të fshatit. Me një oborr të paktë e të pastër. Përreth kish plot hekuri-shta. Tek hyrja i priti dhëndërrin; u buzëqeshi, vuri dorën e mbledhur grusht tek buzët, që dukej sikur s'i rrinin në vend, dhe prapë u buzëqeshi, duke shikuar herë nga krushqit e herë nga hyrja e shtëpisë.

Pinë fare pak, hëngrën darkën jo më vonë se ora dhjetë dhe ranë të flenë. Në një dhomë të porsamartuarit, në tjetrën motrat dhe dy krushkat.

Ishte një hënë e plotë gushti, që u rrinte mu në dritare. Pastaj ajo u zu. Axhemi vuri re që tej, nga xhami i sipërm i dritares, se qielli u nxi, yjet nuk dukeshin më dhe as hëna s'ndriçonte dot. Pas pak vendi u drodh nga të bubulliturit e shtërngatës. Një fasho e shpejtë drite çau errësirën, hyri në shtëpi dhe ndriçoi atë shtrat të thjeshtë.

— Ti mos qa, ç'ke? — i tha ai.

— Jo, se si më vjen! — përshpëriti ajo belbët, e tulatur në atë shtrat të thjeshtë.

— ...

— ...

— Ti qan!

— Ashtu, se si...

Atij njeriu i lëvizën nofullat e dala. Brazdat iu thelluan, dhe tëmthat i rrahën fort.

— Të vjen keq!? — i tha ai, përzier me një zë që dukej sikur delte nga thellësitë. Pastaj u koll një herë, dy herë.

— Jo.

Doje fat tjetër?

— Jo.

— Ashtu?!

— Jo.

— Po pse qan?

— Se si më vjen!

Ajo iu tulat në gji. Ai ngriti flokët e shprishura dhe diç të pakuptueshme i pëshpëriti. Sikur i pëshpëriti asaj, sikur i pëshpëriti vetes.

E ndjente pse qante.

Cila vajzë fshatare s'qan natën e parë të martesës? Megjithatë e pyeste:

— Pse qan, pse qan?

— Ti mos qa... Pse të qash? E...

Ai e pyeste me një zë që vinte duke u shuar. Dhe tek i thosh ashtu «pse qan, pse qan?» edhe vetë e ndjente se nëpër ato lotët e asaj rridhte njëfarë gëzimi i brendshëm.

Ai kaloi kurrizin e dorës nëpër fytyrë. Ra në mendime. Ashtu siç ish shtrirë, me fytyrën drejt errësirës që ish nderur përreth, i dukej sikur ndodhej diku në fushë. Sikur ndodhej atje ndanë lumit, tek ai koteci i madh, i gjatë i kooperativës... Sikur... Sapo ish derdhur nëpër jonxhë ai purpuri i ndezur që kullonte lindja e skuqur. Ai ndalte një çast, dëgjonte tërë ato kakarisje të pulave. Ato ishin zgjuar dhe i dukej atij sikur kishin kohë që e prisnin, sikur tërë ato kakarisje e qortonin që atë ditë kish dalë aq vonë. Ai ndali edhe një çast, pa edhe një herë nga lindja dhe tha: «Tashti duhet të vijë më shpejt. Gëdhihet shpejt tani». Një gjel këndoi fort, përmbi të tjerët. Ai e dëgjoi këngën dhe pëshpëriti: «Të njoh unë ty, o kokosh, të njoh. Ja edhe ca dhe rriten të vegjëlit. S'do të jesh vetëm ti pastaj. Pastaj do të jini shumë... Se ne do të mbajmë edhe ca. S'mund të mbahen tërë ato pula me pesë kokoshë. As vetëm me Llathirin... Llathir! Hëm, hëm, ç'emër! Llathir i thërrasin! E çdo të thotë Llathir? Llathir... Po...» Ai bëlbëzoi emrin e tij dhe në çast mendoi se ç'do të thoshte edhe ai emri i tij. A kish lindur ai së bashku me të?...

Ai çeli deriçkën e një koteci, pastaj i çeli të gjitha me radhë. Në vesh i bubulluan akoma kakarisjet e pulave dhe zërat e zgjatura të gjelave që shpupuloheshin kur dilnin jashtë. Ndenji ca, mbushi edhe një herë mi-



suret me ujë dhe i hypi gomarit bëri andej buzë lumit. Atë rrugë e kishte bërë disa herë. Kish kohë që ndodhte kjo. Mbase që atëhere që, në anën tjetër të lumit, tek ato jonxhat e mbjella rishtaz, ferma kish ngritur kotecët e saj dhe kish shpurë atje pulat. Pulat e kooperativës dhe të fermës asnjëherë s'ishin përzjerë. Ato ndodheshin larg dhe nga njëra anë e lumit tek tjetra mezi vinte si e shuar kënga e ndonjë gjeli që thërriste fort. Ndërsa dimrit rrotulloheshin ujrat e turbullta të lumit dhe uturima e tij pushonte gjithshka. Kështu që dimrit gjithshka ish e siguruar. Lumi e mbushte shtratin edhe askush s'mund të mendonte se mund të qëllonte që të përziheshin pulat e fermës dhe të kooperativës.

Ndërsa tashti në verë... Tashti puna qëndronte ndryshe. Prandaj andej, tek gëmushat e kërlëshura të lumit, duhej gjuajtur edhe dhelpra, edhe sqifteri. Mandej atje, tek ana e tejme e lumit, ndanë kotecëve të fermës, gurgullonte edhe një burim i ftohtë. Thuhej se kohë më parë, ajo blanjë toke ndën burim i takonte fshatrave të kooperativës e jo vendeve të fermës. Pa çka se ndodhej matanë lumit. Po kjo pak rëndësi kish tashti në këtë kohë.

Ashtu si i thërriste gomarit ai, nuk i thërriste askush në ato fshatra. Dhe ashtu si i bindej ai gomar atij, nuk dihej që ndonjë kafshë tjetër t'i bindej të zot, në mbarë atë krahinë. Përjashtojmë këtu historinë e mëzit të Bigo Mares, histori të cilën e tregonin shpesh kafsharët e kooperativës...

Kur u avit ndanë burimit, megjithëse gomari shpejtoi çapat për tek uji i ftohtë e i pastër, ai që ish hipur ja bëri:

— Bërrrr! Naaa!

Diçka të tillë thirri i zoti. Ndërsa gomari ngriti veshët lart dhe ndali menjëherë. Ai zbriti ngadalë dhe u ul ndanë burimit me çiften pranë.

— Na e prishët këtë burim! — i tha duke e flakur mënjanë ujët që kishte në grushte.

Ajo që kish ardhur papritur, tha:

— Jo, aty në krye ai nuk bëhet pis.

— Për besë, fjalë me vend.

Dhe qeshi.

Ajo u qas atje tek gurgullonte uji dhe shtyu brenda një pagure të shtypur vende-vende.

— Do të bini akoma? — foli përsëri ai.

— Do të biem zogj.

— Nga të kllockës?

— Jo, të inkubatorit.

— A ba ba, duan kujdes ata! Për besë duan kujdes! E di që të fëlliqin ata? Duan kujdes. Për perëndi!.

Ai piu ujë të ftohtë nga pagurja e saj. Pastaj ndejnën afër njëri-tjetrit dhe biseduan për shumë gjëra. Bile ai i tregoi se para luftës kish qenë një nga armiqtë e parë të pulave. Kjo vinte mbase, se ai e kish pasur inat beun. Ajo i tregoi për fshatin e saj dhe për babanë që e mbante mend fare pak. Por i vëllai i saj i vogli, ai që ndiqte politeknikumin, i ngjante shumë. Kështu thoshin fshatarët.

I muarën me radhë kohët dhe njerëzit që njihnin. Një ditë ai i tregoi shumë gjëra për luftën, i tregoi edhe për çetën ku kish luftuar. Asaj i dukej sikur e njihje tashmë atë partizanin e plagosur, atë që në fund të fundit ngeli pa sy, por që përsëri ndiqte shokët dhe vazhdimisht këndonte. Tashti ai jetonte akoma, diku në Tiranë. Dhe tregonin se nga kënga s'ish ndarë. E donte jetën shumë. Kur këndonte, i ngjante sikur shihte. Andaj këndonte aq shumë. I tregoi një ditë edhe për veten e vet. Mbase asnjëherë s'kish folur aq shumë për veten e vet sa atë ditë. Kur nisi, s'mundi të ndalej më. Fjalët i rridhnin si rrëke, dhe në ato çaste ai s'mund të heshtëte. E kujt tjetër i kishte folur aq shumë? Askujt.

Në mbrëmje u pendua.

Të nesërmen i foli përsëri asaj. I foli për luftën dhe për veten. I dukej sikur ja kujtonte vetes. Gjithmonë gjëra të reja, të patreguara. Faqeve të saj rignonin lot të ngrohtë, dhe ai ndjente dhimbje tek shihte se si nga sytë e saj rridhnin lot.

Ç'e shtynte atë të qante aq shumë?

Ai partizani i vjetër këndonte dhe shihte pa sy, përmes këngës atje në Tiranë. Pastaj bisedonin për pulat dhe zogjtë e inkubatorit.

Kështu ndodhte çdo ditë. Ky ish një refren i panda-lur i atyre të dyve. Atje tek burimi, buzë lumit, rrinin ndanë njëri-tjetrit dhe vazhdimisht diç të re, të ngrohtë pëshpërisnin, bëlbëzonin. Herë njëri e herë tjetri.

Më vonë, edhe kur pëshpëriste vetëm njëri, atyre u ngjante sikur bëlbëzonin të dy, në të njëjtën kohë, për të njëjtën gjë. Kështu erdh e u ngjiz ajo dashuri. Nuk dije pastaj ku fillonte, cila ishte ajo nyje e pazgjidhshme midis tyre...

Tërë këto atij i veguan sonde dhe në një çast i erdhi vështirë, kur kujtoi se i kish folur asaj për luftën që kish bërë. Ai kish qenë partizan, dhe partizanët...

Nëpër errësirë dëgjohej shiu që sapo kish nisur të pëshpëriste përmbi çati dhe insektet që zhurmonin në një shushuritje monotone, duke brejtur trarët e shtëpisë.

— Ç'dasëm! — tha ajo.

— Kështu e mendova unë.

— Mirë, — tha ajo.

— Kështu na takonte.

Ata heshtën. Përsëri u ndje shiu dhe brejtja e insekteve.

—Po yt vëlla s'u kthye?

— Jo. Kushedi kur do të kthehet. Të gjithë burrat ikën në alarm.

Ua ndali bisedën një shkrepëtimë rrufeje, që shpoi xhamet e hyri në shtratin e tyre. Çatia u rrah me furi dhe pullazet kulluan si ullukë.

— Shpejt! — thirri i alarmuar burri, si të ish çuar nga një botë tjetër.

— Shpejt!

Dhe u çua më bisht.

— Ngrehu, ngruhuni! — ulëriti ai fort.

Vajza çapëu sytë dhe e tronditur iu var burrit për supesh.

— Ç'është, ç'është?

— Shiu për besë, shiu... Këmbën, shpejt këmbën... Ai nuk thirri më: «këmbën, shpejt këmbën» por, si të ish kujtuar për diçka, papritur nisi të zvarrisej vetë atje prapa derës.

Ajo ende s'merrte vesh ç'po ndodhte. Zëri i tij humbiste përmes zhurmës së madhe të shiut që derdhej me gjyma.

Burri u zvarrit vetë deri tek dera. Aty, me hame-ndje, mori diçka dhe mundohej ta lidhte. Ishte një këmbë e huaj prej druri, të cilën e lidhte në vend të asaj këmbe që kish lënë në provokacionet e 49-ës. Dhe sonte kish dasmë. Një dasmë e veçantë kjo.

— Maro, Maro! Eja! Për perëndi shiu, nuk e dëgjon!

— Ç'është?

— Nëm llullan, atje, atje tek penxherja e fundit! Hë, është një teneqe si honi. E gjete? Bjere! Nuk e dëgjon shiun?! Shi! Të gjithë mallin e kemi jashtë.

Ai u çua me vështirësi, u kap pas derës dhe, duke u pështetur pas gruas, u çapit deri tek dritarja. Aty mori diçka dhe menjëherë hapi dritaren.

Atë errësirë të çjerrë nga shiu e shpoi në mes zëri i llahtarshëm i tallallit të fshatit:

— Ehe he heeej! Ehe he... të gjithë njerëzit të venë te hangarët e duhanit e o e! Ehe hej! Eeej...

Në dhomën përbri u ndienë fjalë. Burri kërkoi t'i sillnin gomarin dhe urdhëroi që të niseshin së bashku për te hangarët. Ai ecte rrugës duke zvarritur njëren këmbë dhe herëpashere ndalte dhe thërriste:

— Të gjithë fsha-tarët që ndodhen këtu, të venë te hangarët — oooo, se është duhani jashtë-ooo.

Shiu derdhej me gjyma nëpër flokët e tij, nëpër zverk dhe kërciste papushim në atë llullanë prej llamarine të ngushtë si honi.

LIBRERIA E SATELIT  
BULEVARI

45410

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
<i>Petro Marko</i> — Gjurmë që nuk mbulohen kurrë .....	3
<i>Teodor Laço</i> — Hapat e fundit të «Stërgut» .....	11
<i>Dylber Hasani</i> — Nyja e djegur .....	20
<i>Gjergj Vlashi</i> — Lindja e parë .....	28
<i>Fatmir Gjata</i> — Fas martesës .....	34
<i>Moisi Zaloshnja</i> — Fletë nga ditari i një agronomi .....	39
<i>Skënder Drini</i> — Kumbimet e reja të pyjeve .....	46
<i>Rudi Spahiu</i> — Tërë fshati e përcolli .....	51
<i>Petro Marko</i> — Vagoni 73 .....	58
<i>Vedat Kokona</i> — Tyrbja .....	67
<i>Ferhat Cakaj</i> — Unë, vajza fjalëpakët .....	72
<i>Koço Kosta</i> — Në fushë, ndanë <u>lumit</u> .....	77